



PLANI KOMUNAL I MENAXHIMIT TË MBETURINAVE

2023-2027

Komuna e Gjilanit

1	<i>Prezentimi i Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave</i>	7
1.1	Qëllimi dhe fushëveprimi i planit	7
1.2	Konteksti lokal	11
1.3	Popullsia	12
1.4	Gjendja e mjedisit dhe e biodiversitetit	13
1.5	Të dhënat mbi ekonominë lokale	15
2	<i>Gjendja ekzistuese e menaxhimit të mbeturinave</i>	20
2.1	Të dhënat për mbeturina në komunë	20
2.2	Shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbeturinave	20
2.3	Rishikimi i implementimit të planit	22
2.4	Performance e shërbimit	24
2.5	Performanca financiare e MM	25
2.6	Infrastruktura për ndarje, riciklim dhe deponim të mbeturinave	26
2.7	Menaxhimi i kategorive tjera të mbeturinave	26
3	<i>Objektivat e MM dhe plani operacional</i>	28
3.1	Vizioni i MM	28
3.2	Objektivat dhe caqet e MM	28
3.3	Objektivi 1: Parandalimi dhe reduktimi i krijimit të mbeturinave	28
3.4	Objektivi 2: Ripërdorimi dhe riciklimi i mbeturinave	31
3.5	Objektivi nr. 3: Ofrimi i shërbimeve cilësore, efikase dhe të qëndrueshme të MM	38
3.6	Objektivi nr. 4: Deponimi i sigurt i mbeturinave si mjet i fundit	41
3.7	Objektivi 5: Zhvillimi i kapaciteteve institucionale për menaxhimin e mbeturinave	42
4	<i>Plani i MM në kushte emergjente</i>	43
4	<i>Plani financiar, veprimit dhe i monitorimit</i>	44

Lista e shkurtesave:

AMMK	Agjencioni i Mbrojtjes së Mjedisit të Kosovës
ASK	Agjencioni i Statistikave të Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
BMZ	Ministria federale gjermane për bashkëpunim dhe zhvillim ekonomik
CEDE	Qendra për Edukim dhe Zhvillim të Mjedisit
DRS	Sistemi i kthimit të depozitës
ELV	Automobila mbeturinë
EPR	Përgjegjësia e zgjeruar e prodhuesit
GIZ	Ministria federale gjermane për bashkëpunim dhe zhvillim ekonomik
QeK	Qeveria e Kosovës
ITMB	Impijanti për trajtimin mekanik biologjik
IWMS	Sistemi i menaxhimit të integruar të mbeturinave
JICA	Agjencia Japoneze e Bashkëpunimit Ndërkombëtar
KfW	Kreditanstalt für Wiederaufbau
KIWER	Instituti i Kosovës për hulumtim të ujit dhe mjedisit
KLMC	Kompania për menaxhimin e deponive të Kosovës
KRM	Kompania Regjionale e Mbeturinave
MESPI	Ministria e mjedisit planifikimit hapësinor dhe infrastrukturës
MND	Mbeturina nga ndërtim demolimi
MPEE	Mbeturina nga pajisje elektrike dhe elektronike
MRF	Qendra e rikuperimit të materialit
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
PKMM	Plani komunal për menaxhim të mbeturinave
PPP	Partneriteti publik privat
PZP	Përgjegjësia e zgjeruar e prodhuesit
SIMM	Strategjia e integruar e menaxhimit të mbeturinave
WFD	Direktiva kornizë e mbeturinave

Lista e tabelave

Tabela 1	Të dhënat mbi popullatën
Tabela 2	Bilanci i mbeturinave komunale
Tabela 3	Operatorët e mbeturinave nën përgjegjësi komunale
Tabela 4	Operatorët tjerë të mbeturinave që operojnë në territorin e komunës
Tabela 5	Mbulimi me shërbim në territorin e komunës
Tabela 6	Mbulimi i ofrimit të shërbimit për EF sipas vendbanimit
Tabela 7	Tipologjia dhe frekuenca e ofrimit të shërbimit
Tabela 8	Pajisjet për hudhjen, ruajtjen dhe grumbullimin e mbeturinave
Tabela 9	Pajisjet për grumbullim dhe transport të mbeturinave
Tabela 10	Pasqyra e realizimit të objektivave të PKMM aktual
Tabela 11	Efikasiteti i stafit të shërbimeve të MM
Tabela 12	Performanca e grumbullimit dhe transportit të mbeturinave
Tabela 13	Shpenzimet e sistemit të MM
Tabela 14	Të hyrat dhe arkëtimi i ofrimit të shërbimeve të MM
Tabela 15	Mbulimi i kostove dhe efikasiteti i operimit
Tabela 16	Pasqyra e realizimit të objektivave të PKMM aktual
Tabela 17	Lista e objektivave të planit
Tabela 18	Korniza strategjike e Objektivit 1
Tabela 19	Korniza strategjike e Objektivit 2
Tabela 20	Parashikimet demografike të popullatës
Tabela 21	Parashikimi i gjenerimit të mbeturinave
Tabela 22	Parashikimi i gjenerimit të mbeturinave sipas kompozicionit
Tabela 23	Analiza e potencialit të mbeturinave që mundën të ricikohen
Tabela 24	Korniza strategjike e objektivit 3
Tabela 25	Operacionalizimi i zgjerimit më shërbim
Tabela 26	Mbulimi me shërbim
Tabela 27	Treguesi i prezencës së deponive ilegale
Tabela 28	Efikasiteti i stafit
Tabela 29	Korniza strategjike e objektivit 4
Tabela 30	Korniza strategjike e objektivit 5
Tabela 31	Investimet kapitale sipas objektivave
Tabela 32	Investimet kapitale vjetore
Tabela 33	Numri i stafit direkt të grumbullimit dhe transportit

Tabela 34	Kostot e stafit direkt të grumbullimit dhe transportit
Tabela 35	Kostot e materialit direkt të grumbullimit dhe transportit
Tabela 36	Kostot e naftës për grumbullim dhe transportit
Tabela 37	Kostot e mirëmbajtjes së kamionëve për grumbullim dhe transport
Tabela 38	Kostot e deponimit
Tabela 39	Kostot tjera direkte
Tabela 40	Numri i stafit indirekt dhe administrativ
Tabela 41	Shpenzimet indirekte dhe administrative
Tabela 42	Shpenzimet e zhvlerësimit të infrastrukturës për MM
Tabela 43	Asetet e MM
Tabela 44	Kostot dhe shpenzimet e MM
Tabela 45	Të hyrat e shërbimeve të MM
Tabela 46	Të hyrat nga shërbimet primare të MM
Tabela 47	Korniza e veprimit dhe monitorimit

Fjala e kryetarit

Të nderuar qytetarë të Gjilanit dhe të nderuar lexues, Plani i Menaxhimit të Mbeturinave 2023-2027 që ju prezantojmë në këtë botim është i një rëndësie të veçantë për komunitetin e Gjilanit, i cili është dokument planifikues - strategjik, që adreson zgjidhjen e problemeve në fushën e menaxhimit të mbeturinave në nivel lokal. Qëllimi i Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Gjilanit, 2023-2027, është që të identifikoj dhe ofrojë zgjidhje për problemet prioritare për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Gjilanit, duke synuar në një menaxhim efektiv të tyre, duke i vendosur ato në agjendën e institucioneve përgjegjëse dhe duke marrë në konsideratë në mënyrë të vazhdueshme opinionin e publikut. Objektivat specifike të Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Gjilanit, 2023-2027, janë: të bëjë vlerësimin e gjendjes ekzistuese të menaxhimit të mbeturinave dhe ndikimeve në mjedis nga sektorët e ndryshëm zhvillimor, të identifikoj dhe përcaktoj problemet kryesore në menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Gjilanit, të identifikoj dhe përcaktoj prioritetet kryesore që do të adresohen në kuadër të PKMM- së për periudhën 5 vjeçare, të planifikohen dhe përcaktohen afatet, aktivitetet që do të ndërmerren për zbatim në adresimin e prioritetëve të identifikuar. Vizioni i këtij plani, synon qytetin e Gjilanit me një mjedis të pastër, zhvillim ekonomik të qëndrueshëm me prioritet zhvillimin e bujqësisë, si dhe promovim të trashëgimisë kulturore dhe turizmit.

Ky Plan është në harmoni edhe me dokumentet tjera të Komunës së Gjilanit. Janë marrë për bazë edhe kërkesat e Strategjisë për menaxhim të integruar të mbeturinave 2021-2030 në Republikën e Kosovës e zhvilluar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në përputhje me Ligjin për Mbeturina, kjo strategji paraqet bazën për hartimin e Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunë e Gjilanit, orientimet strategjike dhe kornizën e veprimeve për menaxhimin e mbeturinave.

Prioritetet kryesore për menaxhimin e mbeturinave në komunën e Gjilanit, mbledhja dhe grumbullimi i mbeturinave prej të gjitha vendabimeve të komunës së Gjilanit, rritjen e cilësisë së shërbimit, ndarjen dhe klasifikimin e mbeturinave që në burim, plotësimin e bazës rregullative, programore dhe institucionale për menaxhimin e mbeturinave për përmirësimin e sistemit për grumbullimin e mbeturinave, eliminimi i deponive ilegale të mbeturinave, rritja e nivelit dhe mundësive për ndarje dhe riciklimin e mbeturinave.

Në emër të qytetarëve të Komunës së Gjilanit, falënderoj kontribuesit gjatë hartimit të Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave, 2023-2027 në komunën e Gjilanit,

Grupin punues në nivel komunal për hartimin e PKMM-së, GIZ, KIWER, CEDE dhe ekipin mbështetës teknik duke ju ftuar të gjithëve që këtë dokument strategjik ta konceptojmë si një vlerë të përbashkët, e cila do të rrisë cilësinë e jetës për të gjithë.

Përzemërsisht,

Kryetari i Komunës së Gjilanit

1 Prezentimi i Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave

1.1 Qëllimi dhe fushëveprimi i planit

PKMM-ja paraqet dokumentin bazë me të cilin organizohet procesi i menaxhimit të mbeturinave në nivel të Komunës. Objektivi i këtij PKMM është që të analizon situatën aktuale të menaxhimit të mbeturinave në tërë territorin e komunës (organizimi, administrimi, rregulloret, financat, operimi dhe menaxhimi), të identifikoj çështjet dhe mangësitë, të vlerësoj pikat e forta dhe të dobëta, të propozoj rekomandime për përmirësime të gjendjes dhe përcaktoj vizionin, qëllimet dhe objektivat e reja (afatshkurtra, afatmesme), si dhe të hartoj një Plan Veprimi ku përcaktohen afatet kohore, kostot, autoritetet përgjegjëse si edhe indikatorët respektivë të suksesit për qëllime monitorimi.

Qëllimi i PKMM është ofrimi i kornizës strategjike për menaxhimin e qëndrueshëm të mbeturinave për periudhën pesëvjeqare për territorin e administruar nga komuna në pajtueshmëri me dispozitat ligjore dhe kornizën planifikuese strategjike. PKMM është i hartuar në mënyrën që merr për bazë parimet e menaxhimit të qëndrueshëm të mbeturinave si në vijim:

PKMM trajton vetëm mbeturinat e ngurta, dhe nuk përfshihen mbeturinat e veçanta të cilat nuk janë kompetencë e komunës. Por do të përfshij raportimin e këtyre mbeturinave te institucionet përgjegjëse siç është MMPHI.

PKMM ka si qëllim që të mundësojë dhe të sigurojë:

- Përputhshmëri me Strategjinë e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave (SRKMM) dhe objektivat e saj: duke kontribuar në zbatimin e politikave dhe arritjen e objektivave kombëtare të paracaktuara në fushën e menaxhimit të mbeturinave;
- Identifikimin e prioriteteve në sektorin e menaxhimit të qëndrueshëm të mbeturinave dhe përcaktimit të veprimeve për zgjidhjen e tyre, duke përfshirë të gjithë aktorët e mundshëm për përcaktimin e këtyre veprimeve dhe krijimin e strategjive për zbatimin e tyre në mënyrë efektive, të ndërthurura sipas një Plan Veprimi.
- Opsionet më të mira për menaxhimin e mbeturinave: për të mundësuar grumbullimin dhe trajtimin e mbeturinave në përputhje me objektivat kombëtare.
- Instrumente institucionale, organizative dhe rregullore: mundëson paraqitje të plotë të kuadrit institucional, organizativ dhe rregullator dhe rekomandon masat për përmirësimin e elementëve përbërës të tij, duke përfshirë ato që kontrollojnë mbeturinat në të gjithë sistemin e menaxhimit për të siguruar përputhshmërinë me standardet e menaxhimit të tyre.
- Nevojat financiare për investime: duke përshkruar dhe argumentuar nevojat financiare dhe nevojën për investime për zbatimin e skemave të grumbullimit dhe trajtimit të mbeturinave;
- Burime financiare për investime: duke krijuar një klimë të favorshme për sigurimin e fondeve qeveritare për mbeturina sikurse dhe fonde nga institucione ndërkombëtare.

PKMM do të shërbej si kornizë planifikuese dhe e veprimit për implementimin e sistemit të menaxhimit të mbeturinave, hartimin e buxheteve, përpilimin e planeve investuese, si dhe tërheqjen e asistencës së jashtme.

Vizioni - Komuna e Gjilanit duke u bazuar në synimin e përgjithshëm do të sigurojë që shërbimet për rreth menaxhimit të mbeturinave të përfshijnë mbulueshmërinë e 100 % të territorit të Komunës.

Misioni- Komuna e Gjilanit do të angazhohet maksimalisht për zgjerimin e Shërbimit të Mbledhjes së mbeturinave dhe për ngritjen e cilësisë së shërbimit. Kurse në një afat sa më shkurtër, komuna e Gjilanit planifikon që shërbimin e mbledhjes së mbeturinave të bëjë në formë më modern respektivisht përmes mbledhjes së diferencuar për të inkurajuar riciklimin reduktimin e mbeturinave, ndarja në burim dhe kompostimin.

Masat e Shërbimit të Grumbullimit të Mbeturinave:

- **Masa e Parë** - Ngritja e Cilësisë së Shërbimit në mënyrë të qëndrueshme dhe respektimi i standardit nga të gjithë ata të cilëve u ofrohet shërbimit.
- **Masa e dytë** - Rritja e Mbulueshmërisë me Shërbimin e Grumbullimit të Mbeturinave dhe përmirësimi i situatës financiare që lidhet me shërbimin e grumbullimit dhe largimit të mbeturinave.
- **Masa e Tretë** - Krijimi i strukturave organizative;
- **Masa e Katërt**- Vlerësimi i gjendjes ekzistuese;
- **Masa e Pestë**- Planifikimi operacional i menaxhimit të qëndrueshëm të mbeturinave;
- **Masa e Gjashtë**-Planifikimi financiar për menaxhim të qëndrueshëm të mbeturinave;
- **Masa e Shtatë**- Konsultimet për zbatueshmërinë e planit me përfaqësuesit kryesorë të komunës.

1.1.1 Baza ligjore për hartimin e planit

Akti themelor për menaxhimin e mbeturinave në Kosovë është Ligji 2011-04 L 060 për Mbeturinat i cili rregullon aspektet specifike të menaxhimit të mbeturinave të ngurta dhe llojeve tjera të mbeturinave. Ligji në fjalë ndërmjet tjerash ofron parimet bazë mbi menaxhimin e mbeturinave përfshi klasifikimin e mbeturinave si dhe rolet e përgjegjësive të aktorëve kyq në menaxhimin e tyre, si aspektet e operimit, dhe licencimit të operatorëve.

Në mënyrë specifike **Ligji i Mbeturinave** përmes Nenit 15 i përcakton kompetencat e komunave sa i përket menaxhimit të mbeturinave. Komunitet sipas këtij Neni janë përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e Planeve Komunale të Menaxhimit të Mbeturinave, krijimin e sistemit të menaxhimit të mbeturinave, përzgjedhjes së operatorëve të licencuar si dhe përcaktimit të tarifave dhe mënyrën e arkëtimit të mjeteve. Ligji i mbeturinave është hartuar në masë të konsiderueshme me direktivat përkatëse të KE që e rregullojnë lëminë e menaxhimit të mbeturinave komunale dhe rrjedhave tjera të mbeturinave.

Korniza Ligjore përmban edhe një numër të konsideruar të ligjeve tjera sektoriale të cilat në mënyrë indirekte rregullojnë menaxhimin e mbeturinave. Këto Ligje përfshijnë: **Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit**,

Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neni 17, në të cilin parashihet se komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive, për sa i përket interesit lokal, duke i respektuar standardet e përcaktuar në legjislacionin e zbatueshëm, në fushat që vijojnë: zhvillimin lokal ekonomik, planifikimin urban dhe rural, shfrytëzimin e tokës dhe zhvillimin, zbatimin e rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollimin e ndërtimit, mbrojtjen e mjedisit lokal dhe ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, përfshirë furnizimin me ujë, kanalizimin dhe drenazhin, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugëve lokale, transportit lokal dhe skemave të nxehtësie lokale, etj.

Ligji Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligji Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, Ligji Nr. 04/L-045 për Partneritet Publiko Privat, etj.

Neni 17 i Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, përcakton menaxhimin e mbeturinave si kompetencë të komunave përfshi edhe aspektet e menaxhimit operativ dhe financiar të shërbimit dhe buxhetimit .

Ligji Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike ndërmjet tjerash rregullon aspektet relevante të pronësisë së ndërmarrjeve publike për menaxhimin e mbeturinave, udhëheqjen kooperative. transparencën financiare, dhe formimin e ndërmarrjeve komunale.

Baza ligjore për menaxhimin e mbeturinave në nivelin lokal te Komuna e Gjilanit përfshinë:

- **Rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Gjilanit;**
- **Rregulloren Komunale për Mbrojtjen e Mjedisit;**

Dokumentat tjera planifikuese-ligjore në lëmin e menaxhimit të mbeturinave janë edhe:

- **Strategjia (2021-2030) dhe Plani i Veprimit (2021-2023) për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave në Kosovë-** dokument strategjik që synohet të arrij zhvillimin e integruar dhe të qëndrueshëm të menaxhimit të mbeturinave dhe të ndikoj në ruajtjen e shëndetit publik, zhvillimin social dhe ekonomik të vendit. Dokumenti synon të trajtojë të metat dhe kufizimet aktuale në sektorin e menaxhimit të mbeturinave, duke i përcaktuar dhe realizuar objektivat strategjike.

Dokumente strategjike në nivel lokal që rregullojnë dhe trajtonë aspektet e menaxhimit të mbeturinave:

- **Plani Lokal i Veprimit në Mjedis 2020-2024-** Dokument planifikues - strategjik, që adreson zgjidhjen e problemeve mjedisore në nivel lokal për periudhën 5 vjeçare. Në një kapitull të vecantë ky dokument trajton edhe aspektet e menaxhimit të mbeturinave.
- **Plani Zhvillimor Urban i Komunës së Gjilanit 2006-2015+** i siguron komunës: një strategji të zhvillimit urban dhe këshilla të mëtutjeshme në çështjet fundamentale të planifikimit. Pas aprovimit të tij nga komuna, Plani Zhvillimor Urbanë do ta luan një rol vendimtar në tërheqjen dhe orientimin e investimeve private dhe komerciale. Për më tepër ky planë do të shërbejë si bazë për punët e ardhshme të planifikimit.
- **Strategjia Zhvillimore Lokale,** siguron përmirësimin e aftësive për të vlerësuar mjedisin e tyre, që të marrin veprime të përbashkëta, të krijojnë lidhje midis sektorëve duke siguruar shtimin e vlerës në maksimum, dhe së fundi të lidhet me viset tjera në rajon dhe me tërë botën.

1.1.2 Korniza institucionale për menaxhimin e mbeturinave

Rolet dhe përgjegjësitë e akterëve kyq sa i përket menaxhimit të mbeturinave janë të sanksionuara me Ligjin për Mbeturina dhe aktet tjera relevante ligjore dhe nënligjore. Autoritet kryesore të menaxhimit të mbeturinave janë Ministria e Mjedisit, Planifikimi Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunitet e Kosovës.

Sipas Ligjit të Mbeturinave Ministria menaxhon me mbeturinat e rrezikshme, mbeturinat likuide, industriale dhe të ngjashme. Komunitet nga ana tjetër menaxhojnë me mbeturinat komunale, mbeturinat inerte dhe nga demolimet, mbeturinat e vëllimshme dhe mbeturinat tjera jo të rrezikshme.

Neni 14 i Ligjit të Mbeturinave përcakton kompetencat e MMPHI dhe këto kompetenca përfshijnë ndërmjet tjerash: (i). Hartimin e ligjeve, politikave strategjisë për menaxhimin e mbeturinave; (ii) zbatimin e strategjisë dhe masterplanit; (iii) dhënjen e licencave për operatorët; (iv) dhe krijimin e bazës së shënimeve dhe sistemit informativ për menaxhimin e mbeturinave.

Neni 15 i Ligjit të Mbeturinave përcakton kompetencat e Komunave dhe këto kompetenca përfshijnë ndërmjet tjerash: (i) krijimin e sistemit për menaxhimin e mbeturinave; (ii) hartimin e planit lokal të veprimit për menaxhimin e mbeturinave; (iii) përzgjedhjen e personave të licencuar për menaxhimin e mbeturinave; dhe (iv) caktimin e tarifave të mbeturinave dhe mënyrën e inkasimit të mjeteve.

Autoritet tjera për menaxhimin e mbeturinave janë:

- **Ministria e Zhvillimit Ekonomik** - Menaxhimi i Ndërmarrjeve Publike në Nivel Qëndror përfshi Kompaninë për Menaxhimin e Deponive të Kosovës; caktimi i tarifave për deponimin e mbeturinave
- **Ministria e Shëndetësisë** - Menaxhimin e Mbeturinave dhe Produkteve Medicinale
- **Ministria e Punëve të Brendshme** - Bënë koordinimin në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit nga fatkeqësitë natyrore e të tjera dhe sipas nevojës cakton anëtarët pjesëmarrës në komisionin për vlerësimin e dëmeve eventuale nga mbeturinat.
- **Agjencioni i Veterinës dhe Ushqimit** - është përgjegjës për rregullimin e aspekteve të menaxhimit me mbeturinat me prejardhje shtazore;
- **Dogana e Republikës së Kosovës** - kryen kontrollin, evidentimin dhe mbikëqyrjen e importit, eksportit dhe kalimit transit të mbeturinave
- **Policia e Republikës së Kosovës** - bashkëpunon me agjencionet dhe organizatat e vendeve tjera për identifikimin, luftimin dhe parandalimin e veprimeve të ndaluara dhe keqpërdorimit të mbeturinave.

Rolet dhe përgjegjësitë e organeve komunale në menaxhimin e mbeturinave janë paraqitur si në vijim:

- **Drejtoria për Shërbimeve Publike (DSHPE)** është përgjegjëse për menaxhimin e mbeturinave.
- **Drejtoria për Buxhet dhe Financa** - është përgjegjëse për propozimin e taksave, tarifave dhe ngarkesave tjera komunale si dhe inkasimin e tyre.
- **Kompania "Ekohigjiena" sh.a.**, grumbullon, transporton dhe deponon mbeturinat, pastron rrugët, mirëmban varrezat, kryen shërbimet e dimrit.

1.2 Konteksti lokal

1.2.1 Pozita gjeografike dhe klima

Komuna e Gjilanit shtrihet në një luginë të gjerë midis fushave të pasura bujqësore në juglindje të Kosovës në rajonin e Gjilanit (pjesë e rajonit të vjetër të Anamoravës), i cili kufizohet me rajonin e Prishtinës. Komuna është një 47 km larg kryeqytetit, 60 km nga Aeroporti i Prishtinës dhe 80 km nga Aeroporti i Shkupit (Maqedoni), ka një sipërfaqe prej 392 km² dhe gjendet në një lartësi mbidetare prej 1,000 metrash në majën më lartë të tij në Malet e Karadakut në jug në Stançiq, ndërsa 475 metra në pikën më të ulët të tij në Budrikë. Afër 40% e tokës së saj është e pyllëzuar, ndërsa 60% është bujqësore. Ka një erozion të konsiderueshëm të tokës në pjesën jugore dhe atë lindore të komunës.

Kjo komunë shtrihet në veri-perëndim-jug-lindje, ndërsa lumi Morava rrjedh në jugperëndim dhe verilindje të kësaj komune për tu bashkuar me Lumin e Moravës Jugore para se të rrjedhë në Serbi dhe në Danub. Gjilan nuk është larg nga qendrat kryesore industriale dhe tregtare të vendit. Qyteti gjendet në udhëkryqin e rrugëve nacionale midis kryeqytetit dhe Preshevës në kufi me Maqedoninë dhe midis Ferizajt dhe Serbisë.



Klima

Duke u bazuar në pozitën gjeografike dhe vetë orografinë e relievit, Regjioni i Gjilanit diferencohet pak prej atij të Prishtinës dhe Ferizajt. Temperatura mesatare e muajit më të ftohtë është shënuar në janar -0,90°C, krahasuar me atë në Prishtinë -1-30°C dhe Ferizaj -1-40°C. Temperatura mesatare me vlera më të larta është shënuar në korrik: 20,7°C. Pranvera dhe vjeshta, karakterizohen me kalime të lehta dhe jo shumë të theksuara, por me ndryshime graduale. Stina e pranverës, me temperaturë mesatare rreth 9,9°C, është më e ftohtë se sa ajo e vjeshtës, e cila shënon temperaturë mesatare prej 11,3°C. Vlerën më të lartë të temperaturës mesatare vjetore, Gjilani e ka shënuar me 10,40°C. Duke filluar prej pjesëve më të ulëta të pjesës fushore dhe luginës së Moravës, në drejtim të pjesëve më të larta të relievit, sasia e reshjeve vjen duke u shtuar. Sasia e reshjeve vjetore në Gjilan është 583 mm, gati sa është edhe ajo në Prishtinë e në Dardanë (596 mm). Sasia më e madhe e reshjeve bie në nëntor, 761 mm. dhe në dhjetor (në lokalitetin Dunav 1.010 mm, e më pak në muajin gusht - 31,4 mm). Bora është dukuri e shpeshtë në viset e Karadakut, të Gallapit dhe të Maleve të Zhegocit, e cila ka trashësi të madhe dhe zgjatë më shumë sesa në viset e ulëta, që ka trashësi më të vogël dhe zgjatë më pak. Në

viset kodrinore-malore të Karadakut, sasia e reshjeve është më e madhe; verërat janë më të shkurtra dhe të freskëta, ndërsa dimrat diç më të gjatë e më të ftohtë.

1.3 Popullsia

Popullsia e Gjilanit, përherë ka qenë e përzier, por me një shumicë dominuese të shqiptarëve, si gjatë sundimit turk, ashtu edhe atij serbo-jugosllav.

Sipas të dhënave zyrtare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës¹ të vitit 2011, Komuna e Gjilanit ka 42 vendbanime poashtu edhe sipas zonave kadastrale, ku jetojnë 90,187 banorë. Pjesa më e madhe me 55.75% i takon grup-moshës 20 - 64 vjeçare.

Tabela 1. Numri i banorëve sipas grup-moshave

	0 - 4 vjeç	5 - 14 vjeç	15 - 19 vjeç	20 - 64 vjeç	≥ 65 vjeç
Nr. i banorëve	6409	17055	9824	50336	6563
% e banorëve	7.11%	18.91%	10.89%	55.81%	7.28%

Pjesa më e madhe e banorëve, gjegjësisht 97.49% i takon etnisë shqiptare, gjersa 1.09% të banorëve janë të përkatësisë turke.

Tabela 2. Numri i banorëve sipas etnicitetit

	Shqiptar	Serb	Turk	Boshnjak	Rom	Ashkali	Egjiptian
Nr. i banorëve	87914	624	978	121	361	15	1
% e banorëve	97.49%	0.69%	1.08%	0.13%	0.40%	0.02%	0.00%

Me 99.15% pjesa dërmuese e banorëve i takon besimit islam, gjersa 0.70% i takojnë besimit ortodoks. Sipas regjistrimit të fundit zyrtar të vitit 2011, rezulton se në Komunë jetojnë gjithsejtë 17,115 ekonomi familjare, prej të cilëve 10,756 në zonë urbane dhe 6,359 në zonë rurale.²

Tabela 3. Karakteristikat e ekonomive familjare

	Ekonomi familjare	% e EF	Anëtarë	% e anëtarëve
Zonë urbane	10,756	62.85%	54,239	60.15%
Zonë rurale	6,359	37.15%	35,939	39.85%

Përqindja më e madhe 22.50% e ekonomive familjare janë 5 anëtarëshe, kurse 18.51% familje 4 anëtarëshe.

Mosha dhe struktura gjinore e popullsisë

Sipas të dhënave të zyrtare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës të vitit 2011, bilanci gjinor është i baraspeshuar, ku 49.71% të popullsisë janë femra dhe 50.29% të popullsisë janë meshkuj, gjersa sa i përket grupmoshave, me 46.14% dominon grupmosha 0 – 24 vjeçare, 34.84% i takojnë grupmoshës 25 – 45 vjeçare dhe 19.01% i takojnë grupmoshës vjeçare 50+.

Tabela 4. Mosha dhe struktura gjinore e popullsisë

¹Agjencia e Statistikave të Kosovës, Popullsia sipas gjinisë etnicitetit dhe vendbanimit, Prishtinë, 2013

²Agjencia e Statistikave të Kosovës, Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës 2017, Prishtinë, 2017

Grupmosha	0-14	15-19	20-24	25-29	30-34	35-39	40-44	45-49	50-54	55-59	60-64	65+	Gjithsej
Meshkuj	12,084	5,056	4,435	3,469	3,058	3,012	3,204	2,797	2,237	1,629	1,299	3,074	45,354
Femra	11,380	4,768	3,887	3,184	3,048	3,529	3,305	2,818	2,207	1,712	1,506	3,480	44,824
Gjithsej	23,464	9,824	8,322	6,653	6,106	6,541	6,509	5,615	4,444	3,341	2,805	6,554	90,178

Dendësia e popullsisë

Dendësia mesatare e popullsisë bazuar në sipërfaqen ekzistuese në zonat rurale dhe urbane është 2.30 banorë për hektarë, ku në zonën urbane është 31.90 banorë për hektarë, gjersa në zonën rurale është 0.96 banorë për hektarë.

Tabela 5. Dendësia e popullsisë

Vendbanimet	Banor (nr.)	Sipërfaqe (Ha)	Dendësi (Ban./ha)
Zonë urbane	54,221	1700	31.90
Zonë rurale	35,957	37469	0.96
Gjithsej	90,178	39169	2.30

Në Komunë shtrihen 1 vendbanim 10 – 100 banorë për hektarë dhe 41 vendbanime nën 10 banorë për hektarë.

1.4 Gjendja e mjedisit dhe e biodiversitetit

1.4.1 Biodiversiteti

Biodiversiteti i Gjilanit është i shumëllojshme, në gjitha mjediset ujore, tokësore malore, urbane etj. Kjo llojllojshmëri është rezultat i kushteve jetësore që ekzistojnë në natyrë. Po ashtu, është kushtëzuar nga relievi, përbërja gjeologjike dhe pedologjike e tokës, nga klima, nga hidrografia dhe nga ndryshimi i vazhdueshëm që është bërë si në të kaluarën ashtu edhe sot.

Zoodiversiteti

Në pyjet e gjëra të ahut, në zonën e Karadakut jetojnë: ujku, dhelpra, qelbësi, ariu i murrmë, kunadhja e pishës, macja e egër, rrëqebulli, vjedulla, kaprolli, dhia e egër dhe derri i egër. Rajoni i Gjilanit ka shumë lloje lakuriqësh dhe shumë lloje shpendësh. Në kuadër të shpendëve dallohen: mishngrënësit si Shqiponja e maleve dhe disa lloje të fajkonjve të cilët ndodhen në fushat rreth lumit Morava, nga shtegtarët (lejleku, dallëndyshja). Herpetofauna: shumë zvarranikë, si: hardhucat, gjarpërinjtë, gjarpërinjtë e ujit, bolla, nepërka helmuese, dhe amfibie (ujëtokësore), si bretkosa.

Në ujëra jetojnë disa lloje peshqish, ndër ta më e njohura është trofta, e cila në lumenjtë në rrjedhat e poshtme më nuk ekziston.

Fitodiversiteti

Rajoni i Gjilanit ka florë të pasur, me lloje të ndryshme bimësh: të ulëta dhe të larta. Bimët e ulëta. Në këtë rajon janë të përfaqësuara nga algat e ndryshme, kërpudhat dhe likenet. Kërpudhat në komunën e Gjilanit janë të përhapura, si: ushqyese, helmuese dhe parazitë, gati në gjitha mjediset,

Farëzhveshura, më të njohura janë: pisha e bardhë, pisha e zezë, dëllinja dhe harmoçi.

Ndotja e mjedisit në tërë territorin e Kosovës është një problem mjaft serioz dhe është prezent pothuaj kudo. Po ashtu edhe në komunën e Gjilanit kjo çështje është evidente. Ndotja më e madhe bëhet me lëshimin e ujërave të zeza nga kanalizimet e vendbanimeve si dhe nga objektet industriale direkt në lumenj, dhe hedhja e mbeturinave të ngurta pranë rrugëve dhe lumenjve përbën një problem të madh. Në përputhje me Planet Zhvillimore Komunale, ekziston mundësia e krijimit të kapaciteteve të nevojshme të cilat minimizojnë gjasën e shkaktimit të fatkeqësive, si dhe krijojnë hapësira dhe kushte për intervenim adekuat të njësive emergjente. Komuna ka për obligim që në të ardhmen të krijoj kapacitete të mjaftueshme për parandalim, reagim dhe rikuperim në rast të fatkeqësive në përputhje me Planin e Vlerësimit të Rrezikut dhe Planin e Reagimit Emergjent.

1.4.2 Ndotja e ajrit

Në komunë të Gjilanit, ekziston vetëm një matës të ndotjes së ajrit. Ajri është më i ndotur në qendrën urbane, ndotje që shkaktohet nga pluhuri, si pasojë e djegies industriale dhe trafiku (gazrat e liruar nga makinat e vjetra dhe pa katalizator). Ndotja e ajrit shkaktohet nga përdorimi i lëndëve të ndryshme djegëse, në mungesë të imiantit qendror të ngrohjes për qytetin.

1.4.3 Ndotja e ujit

Vendbanimet pa qasje në sistemin e ujësjellësit, sigurojnë ujin e pijes nga pusët individuale apo kolektive, të cilat shpesh nuk mirëmbahen si duhet. Këto puse nuk janë të ndërtuara si duhet dhe ndodh të ndoten nga ujërat sipërfaqësorë (si ujëra të zeza apo të kulluara) gjë që përbën një rrezik të vazhdueshëm për shëndetin e popullatës.

Dihet se komuna e Gjilanit nuk posedon as një impiant për trajtimin e ujërave të zeza. Ekzistojnë disa grupa septike në vendbanime të ndryshme si në: Shillovë, Përlepnice, Bresalc, Livoq i Ulët, Llashticë, Llovçë të cilat trajtojnë pjesërisht ujrat e zeza. Pjesa tjetër e ujërave të ndotura derdhen në lumenj dhe përroska ku ndjeshmëria e ujërave nëntokësore dhe mbi tokësore është e nivelit më të lartë. Liqenjtë, lumenjtë dhe rrjedhjet tjera ndoten nga hudhja e mbeturinave.

1.4.4 Ndotja e tokës

Ndikimi i vazhdueshëm nga aktivitetet njerëzore sjellë deri te degradimi i sipërfaqeve tokësore duke shkaktuar edhe pasoja të dëmshme mjedisore dhe socio-ekonomike. Çdo ngjarje, veprim që prish veçoritë dhe cilësitë natyrore të kësaj hapësire jetike emërtohet ndotje e tokës. Nga ndotja e tokës në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë preken të gjitha gjallesat. Shumica e faktorëve që krijojnë ndotjen e tokës vijnë nga shkaqe njerëzore, ku ndër më kryesoret janë: Deponimi apo hudhja në natyrë e mbeturinave shtëpiake dhe mbetjeve industriale, gazrat e shkarkuara, pesticidet dhe plehurat kimike apo përdorimi i tepruar i tyre në bujqësi, erozionet që vijnë nga shkatërrimi i pyjeve sidomos në zonën e pyjeve.

1.4.5 Ndotja nga zhurma

Në Komunën e Gjilanit burim kryesor i zhurmës është komunikacioni, Industria e cila zhvillohet në mënyrë të shpërndarë brenda vendbanimeve, gurëthyesit të cilët zhvillojnë një bezdisje të

vazhdueshme. Ndërsa si zhurma tjera të cilat zhvillohen nga pakujdesia e të cilat janë akute zhvillohen në gjitha pjesët e komunës duke e prishur rendin dhe qetësinë publike.

1.5 Të dhënat mbi ekonominë lokale

Historikisht, ekonomia është dominuar nga tregtia dhe zejtaria. Gjatë kohës së Jugosllavisë, kjo zonë ka pasur një ekonomi relativisht stabile që është përbërë nga prodhimi i tekstilit dhe duhanit dhe nga industria e baterive, si dhe nga një fabrikë e radiatorëve dhe impiantet për mihje dhe konstruksione të çelikut, një kompani e hidroingjnierisë, një thertore dhe një mulli. Të gjitha këto industri nuk janë ruajtur që nga viti 1990, ndonëse fabrika e radiatorëve është ende në funksion, ndërsa po bëhet një studim i fizibilitetit për ta shqyrtuar mundësinë e rihapjes së fabrikës së duhanit.

Shtyllë kryesore e komunitetit është bujqësia: perimet, pemët (molla, dardha, kumbulla, qershia, kajsia, pjeshka, ftoi, dredhëza, rrushi) dhe blegtoria. Në vitin 2009, afro 44% e popullatës ka qenë e përfshirë drejtpërsëdrejti në bujqësi. Situata ka ndryshuar paksa pas reformës territoriale administrative të vitit 2010, gjatë së cilës zona e këtij komuniteti është tkurrur nga 515 km² në 392 km². Tani Gjilani e ka një qendër komunale të biznesit, ndërsa po bëhet një studim i fizibilitetit për ndërtimin të edhe një zone industriale me lokacion në Llabjan, e cila do të ndahet me komunën e Novobërdës dhe do të funksionojë në kuadër të bashkëpunimit ndërkomunal.

Turizmi

Komuna e Gjilanit ka potenciale të mira për zhvillimin e llojeve të caktuara të turizmit, investimet e bëra kohëve të fundit nga sektori privat në turizëm ofertën turistike të Gjilanit e bëjnë atraktive për klientelën turistike vendore e ndërkombëtare. Malet e Zhegocit, Malet e Kardakut, janë aset në vete për këtë komunë ku mund të zhvillohet turizmi rural e njëkohësisht edhe turizmi i kalërimit, çiklizmit e motoçiklizmit, ecjes në natyrë etj.

Trashëgimia kulturore në shërbim të zhvillimit të turizmit Kalaja e Pogragjës, gjendet në kilometrin e 10 nga qyteti i Gjilanit, në fshatin Pogragjë, krahas kalasë është mjaft atraktive edhe Gryka e Llapushnicës. Atik Xhamia, Xhamia e Cernicës, Xhamia e Dobërqanit, Kisha katolike „Kisha e Shën Anës” në fshatin Dunav, Tyrbet në qytet, Kisha e Shën Nikollës, Sahat Kulla. Pastaj janë Atraksionet Natyrore: Penda e Livoqit, Lokaliteti Stublinë, Lokaliteti Zhegoc me rrethinë, burimet termale në Uglar dhe Dobërqan

Ndërtimtaria

Gjilani ka një traditë të hershme në ndërtimtari. Kështu, në këtë veprimtari në vitet e '80 u punësuan mbi 2.000 veta. Hovin e rritjes, jo vetëm në Gjilan e rrethinë, por edhe në tërë Kosovën e më gjerë, ndërtimtaria e arriti në sektorin e ndërtimit të banesave si dhe për prodhimin e elemente të parafabrikuara deri para luftës së fundit. Kjo veprimtari ekonomike në komunën e Gjilanit fillet e zhvillimit të saj i ka herët, ndërsa hovi i zhvillimit dhe i modernizimit të kësaj veprimtarie është bërë viteve të fundit. Selitë e ndërmarrjeve ndërtimore janë të vendosura kryesisht në pjesët periferike të qytetit, ndërsa byrotë projektuese janë më tepër të vendosura në brendi të qytetit. Në Komunën e

Gjilanit janë 166 ndërmarrje ndërtimore dhe byro projektuese të cilat iu ofrojnë qytetarëve shërbimet: projektet ideore, projektet kryesore, realizimin e tyre (ndërtimin) dhe mbikëqyrjen e tyre, kurse të punësuar janë 1115 punëtorë. Furnizimin me materiale ndërtimore bëhet nga tregu i brendshëm i Kosovës dhe nga importi nga shtetet ballkanike edhe ato të Evropës perëndimore. Në komunën e Gjilanit deri në vitin 2015 kanë vepruar 5 gurëthyes.

Industria

Ndërmarrjet, bartëse të zhvillimit të ekonomisë së Gjilanit, ardhmëria e tyre qëndron në procesin e privatizimit i cili shkon me një ritëm shumë të ngadalshëm, edhe pse disa prej tyre tani punojnë me një kapacitet të kufizuar, janë:

Fabrika për Prodhimin e Konstruksioneve të Çelikut “Çeliku”,

Fabrika e Radiatorëve dhe Këmbyesve të Nxehtësisë “Jugoterm”,

Fabrika për Përpunimin e Duhanit “IDGJ”,

Kombinati i Tekstilit “Integj”,

Ndërmarrja Hidro Ndërtimore Industriale “Morava e Binçës”.

Këto kapacitete, edhe pse në shumicën e rasteve janë të vendosur në qytet, janë shumë të rëndësishme edhe për zhvillim rural, sepse këtu mund të punësohen edhe punëtorë nga zonat rurale.

Tregtia

Tregtia si degë e ekonomisë zë vendin më të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të komunës së Gjilanit me 1,730 biznese të regjistruara apo 56.1% të bizneseve të regjistruara. Këto biznese veprojnë si ndërmarrje dhe shitore tregtare të cilat iu ofrojnë konsumatorëve lloje të ndryshme të mallrave si që janë: mallra ushqimore, mallra të higjienës, tekstilit, galanterisë së lëkurës, aparateve të amvisërisë, mobilierisë dhe mallrave të tjera të konsumit të gjerë. Zhvillimit i tregtisë private në komunën e Gjilanit ka filluar nga fundi i viteve të tetëdhjeta, ndërsa hovi i zhvillimit dhe i modernizimit të tregtisë është bërë në vitet e fundit duke e shfrytëzuar edhe marketingun si mjet kryesor për rritjen e konsumit të mallrave. Mallrat kryesisht importohen nga vendet fqinje si Shqipëria, Maqedoni Veriore a, Serbia, Mali i Zi, Turqia, Greqia, Bullgaria dhe shtetet tjera të Evropës perëndimore si dhe kohëve të fundit me një hov më të madh nga tregu i Kosovës. Objektet shitëse kryesisht janë të ndërtuara në brendi të qytetit dhe pjesërisht në periferi të qytetit si dhe në fshatrat e Komunës së Gjilanit sidomos përgjatë korridoreve të akseve të rrugëve nacionale dhe regjionale. Në këto ndërmarrje janë të punësuar 3455 punëtorë.

Bujqësia

Me fillimin e procesit të privatizimit, pjesa dërrmuese e ndërmarrjeve të përmendura agrare ndërruan destinimin e tyre. Ish kombinati bujqësor Mlladost është privatizuar 80% dhe ka ruajtur destinimin dhe rezultojë në krijimin e dy kompanive private si MOEA dhe AskFood me kapacitete pemëtarie në sipërfaqe prej afër 200ha dhe kapacitete përpunuese. AskFood eksporton prodhime të veta në Gjermani, Shqipëri, etj. Këto dy kompani kanë afro 150 punëtorë të rregullt dhe 200 punëtorë sezonal.

Në Komunë aktualisht veprojnë gjithsej 20 ndërmarrje bujqësore private. Sa i përket shfrytëzimit të tokës bujqësore, nga 18,399.28ha sipërfaqe të përgjithshme, 43.86% e sipërfaqes është e kultivuar me prodhime bujqësore, 10.81% nuk shfrytëzohet për kultivime bujqësore, gjersa 44.79% shfrytëzohet për livadhe dhe kullosa.

Shfrytëzimi aktual i tokës bujqësore (ha)

Toka bujqësore		Toke bujqësore e kultivuar	Toke bujqësore jo e kultivuar	Livadhe dhe kullosa
Sipërfaqja	18399.94ha	8114.56 ha	2000ha	8285.44ha
Përqindja	100%	44,11 %	10.87 %	45.02%

Sa i përket prodhimtarisë së drithërave gjatë vitit 2017, me 35.57% dominon prodhimi i Grurit, pastaj i Elbit me 30.20%, i Misrit me 17.45% dhe i Tërshërës me 16.78%, gjersa nga bimët foragjere me 69.23% dominon prodhimi i Jonxhës, pastaj i Barit me 30.77%.

Blegtoria

Përveç fermave të pulave, që kishin një mbarështim të racave të pastra llojet tjera të kafshëve shtëpiake ishin kryesisht metisë që nuk kanë dhënë rendimente të larta në prodhimtarinë e mishit, qumështit, leshit dhe produkteve të tjera. Plantacionet në Kravaricë dhe Ferma e pulave Konsoni në fshatin Livoç i Poshtëm arritën të ruajnë subjektivitetin e tyre të ringjallin prodhimin e mëparshëm, gjersa Konsoni ka hapur thertoren për brojlerë me një kapacitet vjetor prej 600,000 kg mish. Kjo fermë ka 60 punëtorë të rregullt dhe një numër të caktuar punëtorësh sezonal me një perspektivë të ndritshme zhvillimore. Sa i përket fermave familjare, përpos Burnicës dhe Dunavit, në të gjitha vendbanimet ka ferma familjare.

Turizmi

Komuna e Gjilanit ka potenciale të mira për zhvillimin e llojeve të caktuara të turizmit, investimet e bëra kohëve të fundit nga sektori privat në turizëm ofertën turistike të Gjilanit e bëjnë atraktive për klientelën turistike vendore e ndërkombëtare. Për nga aspekti turistik komuna e Gjilanit mund të ndahet në këto lokalitete turistike: Malet e Zhegovcit; Malet e Karadakut (ose Malet e Zeza), Malet e Sllubicës, Lugu i Haxhajve të Zhegrës, Lugu i Bukovikut, Lugu i Burincës, Gryka e Llapushnicës, Shpella e Bresalcit, Shpella e Resulës, Lumi Morava e Binçës, Lumi Mirusha, Liqeni i Livoqit, Uji Mineral i Nasalës, Burimi i ujit në fshatin Pidiq, si dhe Banjat minerale: Banja e Uglarit, Banja e Mireshit, dhe Banja e Dunavit. Shikuar në aspektin e zhvillimit turistik, komuna e Gjilanit përbëhet nga këto lokalitete turistike:

Zejtaria

Zejtaria si degë e mëvetësishme ekonomike si dje ashtu edhe sot, zë një vend të rëndësishëm në jetën e popullatës së kësaj hapësire. Natyrisht sot në Gjilan si qendër urbane kryesore e kësaj ane, zejtaria më nuk e ka atë rol, që e kishte në shekujt e kaluar, por megjithatë e transformuar në veprimtari të ngjashme e të natyrës tjetër, edhe sot tregohet të jetë me rol dhe e rëndësishme në jetën e banorëve, të hapësirës përkatëse. Po të analizohet veprimtaria zejtare përgjithësisht, ose llojet e zejeve që dikur ishin të zhvilluara në këto anë, në disa raste na shfaqet lidhshmëri manifestuese e diversitetit ofertues dhe e begatisë ekonomike të mjedisit-hapësirës ekologjike dhe ekonomike, që nxitë dhe furnizon

mjedisin shoqëror dhe ekonomik të këtyre anëve. Fjala vjen, do të shohim se dikur ishte shumë e zhvilluar veprimtaria e kultivimit të duhanit, ose e konopitarisë. Sot në Gjilan ekziston një zonë e zejtarëve ku veprojnë 33 kryesisht, artarë dhe argjendar, ndërsa në pjesë tjera të qyteti dhe fshatra veprojnë edhe Zejtari Rrobaqepësie, ndreqje flokësh dhe zbukurim, fisnikërim të metalit, përpunim lëkure dhe druri, prodhim betoni dhe argjili.

Administrata publike

Komuna e Gjilanit i ka dymbëdhjetë drejtori: 1, Administratën e Përgjithshme; 2, Shëndetësinë dhe Mirëqenien Sociale; 3, Arsimin; 4, Buxhetin dhe Financat; 5, Mbrojtjen Urbane dhe të Mjedisit; 6, Inspeksionin; 7, Shërbimet Publike, Infrastrukturën dhe Strehimin (përgjegjëse për menaxhimin e mbeturinave); 8, Bujqësinë dhe Pylltarinë; 9, Kulturën, Rininë dhe Sportin; 10, Kadastrën dhe Gjeodezinë; 11, Mbrojtjen dhe Shpëtimin; 12, Ekonominë dhe Zhvillimin (shih Organogramin). Ajo i ka edhe njëmbëdhjetë zyra: Kuvendin; Kulturën, Rininë dhe Sportin; Komunitetet dhe Migrimin; Zyrat për Preshevë, Medvegjë dhe Bujanovc; Të Drejtat e Njeriut; Integrimin Evropian; Informimin; Zyrën Ligjore; Personelin; Prokurimin; Auditimin e Brendshëm.

Shëndetsia

QKMF funksionon me 13 QMF dhe 9 AMF ,me një numur të punëtorëve gjithsej 272: mjek, infermier dhe punëtor ndihmës. Të gjitha QMF-ët dhe AMF-ët janë në funksion dhe me një infrastruktur normale përveq AMF Llashticë e cila gjendet në një objekt që nuk i plotëson kushtet për ofrim të shërbimeve shëndetësore dhe është në plan që të ndërtohet një ambulancë e rë në një afat të shkurtur apo afatmesëm. Shërbimi publik shëndetësor në komunën e Gjilanit është i organizuar në tri nivele: Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) në Gjilan, 12 Qendra të mjekësisë familjare (QMF) në Dardani, Arbëri, Zhegër, Cërnica, Pogradec, Brelca, Perlepnica dhe Malishevë) dhe 9 ambulanca të mjekësisë familjare (AMF) në Gjilan, Uglarë, Livoç i Ulët, Llashticë, Shurdhan, Kishnapolë, Verbicë, Shillovë dhe Ponesh. Sipërfaqet e ndërtesave shëndetësore dallojnë në varësi të nivelit të shërbimit. Sipërfaqet e ambulancave sillen prej 95 deri 150 m² ndërsa sipërfaqet e QMF-ve prej 150 deri në 650m². QKMF në Gjilan ka rreth 1600 m², sipërfaqe kjo e pamjaftueshme në raport me ngarkesën e pacientëve që gravitojnë në këtë qendër. Në nivel komunal, procesi arsimor zhvillohet në tri nivele: arsimi parashkollor, fillor dhe i mesëm. Rrjeti i ndërtesave të arsimit përbëhet prej:6 Çerdhe/ Kopshte për fëmijë;46 Institucione të arsimit parafillor, fillor dhe të mesëm të ultë;11 Institucione të arsimit të mesëm të lartë;1 universitet Arsimit fillor organizohet në 46 shkollat fillore dhe në 11 të mesme, ku janë të përfshirë 21 050 nxënës, ndërsa në procesin edukativo-arsimor janë të angazhuar 1552 të punësuar, prej tyre 1501 mësimdhënës dhe 51 edukatorë. Të gjitha shkollat në Komunën e Gjilanit janë publike, përfshirë arsimin fillor dhe të mesëm. Në qytet ka 8 shkolla fillore dhe 5 shkolla të mesme si dhe konvikti i nxënësve dhe studentëve.

Arsimi

Gjilani ka arsimin fillor, të mesëm dhe superior. Hapësira e shfrytëzimit për një nxënës, në qytet është 0.65 m/2, ndërsa në fshat 1.1 m/2. Arsimi fillor përbëhet prej 20 shkollave fillore dhe 3 qerdheve për fëmijë, me mësim në gjuhen shqipe si dhe 7 shkollave fillore në gjuhen serbe dhe 2 në atë turke. Numri i nxënësve shqiptarë në këtë nivel të shkollimit është 18.559. Mësimdhënës - 1.023. Shkollat serbe si mësimi në gjuhën turke vijohet nga 1.873 nxënës, ndërsa numri i mësimdhënësve është 188. Komuna e Gjilanit ka 12 shkolla të mesme, 6 prej tyre në gjuhen shqipe, me 6.033 nxënës dhe 380 mësimdhënës si dhe 6 shkolla tjera në gjuhen serbe, me 799 nxënës dhe 107 mësimdhënës. Në Gjilan ka filluar punën edhe Fakulteti i Edukimit, me 104 studentë dhe 6 mësimdhënës, përderisa në SHLP “Skënderbeu” vijnë 629 studentë, ku punojnë edhe 19 punëtorë. Gjilani nuk ka shkollë të veçantë speciale, por në shkollat fillore “Abaz Ajeti” dhe “Thimi Mitko” ekzistojnë klasë speciale për fëmijë të paafatë dhe me të meta mentale.

Plani Lokal i Veprimit në Mjedis 2020-2024- Dokument planifikues - strategjik, që adreson zgjidhjen e problemeve mjedisore në nivel lokal për periudhën 5 vjecare. Në një kapitull të veçantë ky dokument trajton edhe aspektet e menaxhimit të mbeturinave.

Plani Zhvillimor Urban i Komunës së Gjilanit 2006-2015+ i siguron komunës: një strategji të zhvillimit urban dhe këshilla të mëtutjeshme në çështjet fundamentale të planifikimit. Pas aprovimit të tij nga komuna, Plani Zhvillimor Urbanë do ta luan një rol vendimtar në tërheqjen dhe orientimin e investimeve private dhe komerciale. Për më tepër ky planë do të shërbej si bazë për punët e ardhshme të planifikimit.

Strategjia Zhvillimore Lokale, siguron përmirësimin e aftësive për të vlerësuar mjedisin e tyre, që të marrin veprime të përbashkëta, të krijojnë lidhje midis sektorëve duke siguruar shtimin e vlerës në maksimum, dhe së fundi të lidhet me viset tjera në rajon dhe me tërë botën.

2 Gjendja ekzistuese e menaxhimit të mbeturinave

2.1 Të dhënat për mbeturina në komunë

Gjenerimi dhe kompozicioni i mbeturinave:

Nga analizimi dhe përpunimi i të dhënave të raporteve nga komuna dhe operatori për mbledhjen dhe transportin e mbeturinave komunale KRM “Ekohigjiena” Sh. A. (tutje operatori) është siguruar një bazë solide e të dhënave për të nxjerrë një rezultat të besueshëm të nivelit të gjenerimit të mbeturinave komunale gjatë vitit 2021. Duhet të cekim se këto dhëna nuk mjaftojnë për të siguruar një pasqyrë të kompozicionit të mbeturinave në nivel të komunës.

Megjithatë, bazuar në të dhënat e siguruar nga raportet e komunës dhe operatori, prej sasisë totale të mbeturinave të grumbulluara mund të llogaritet një gjenerim mesatar i mbeturinave për banorë në nivel të komunës së Gjilanit. Kështu nga 25,0125 ton mbeturina komunale të grumbulluara në komunën e Gjilanit për vitin 2021, si dhe numrin e banorëve të shërbyer që është vlerësuar në 83,465 banorë, rezulton se gjenerimi i mbeturinave komunale për kokë banori në komunën e Gjilanit për vitin 2021 të jetë në 301 kg/banor/vit.

Tabela 2: Bilanci i mbeturinave komunale				
Kategoria	Mënyra e përcaktimit të sasisë	Mbeturinat e grumbulluara	Mbeturinat e ricikluara / tregtuara	Mbeturinat e deponuara
Mbeturina mikse komunale	25, 125 t	25, 125 t	-	25, 125 t
Total:	25, 125 t	25, 125 t	-	25, 125 t

2.2 Shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbeturinave

Operatorët e shërbimit të grumbullimit dhe transportit

Në komunën e Gjilanit vepron si i vetëm operatori për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave komunale KRM Ekohigjiena SHA e cila është në pronësi publiko private. Operatori është i licencuar në MESPI dhe i kontraktuar nga komuna. Krahas këtij operatori ekzistojnë edhe disa operatorë të riciklimit të cilët janë të palicencuar dhe të cilët nuk janë pjesë e sistemit të organizuar të menaxhimit të mbeturinave. Një nga ata është edhe kompania MMS.

Tabela 3: Operatorët e mbeturinave nën përgjegjësi komunale					
	Emri i operatorit (biznesit)	Forma e pronësisë	Kategoria e menaxhuar e mbeturinave	Mbulimi me shërbim %	Statusi i kontraktimit (po/jo)
Operatori 1	Ekohigjiena SHA Gjilan	PPP	Mbeturina komunale	100	PO

Tabela 4: Operatorët tjerë të mbeturinave që operojnë në territorin e komunës				
	Emri i operatorit (biznesit)	Forma e pronësisë	Kategoria e mbeturinave të menaxhuara	Sasia e mbeturinave të menaxhuara

Operatori 1	MMS	Private		NA
-------------	-----	---------	--	----

Mbulimi me shërbim:

Mbulimi me shërbim për EF në komunë është 93.2% ndërsa mbulimi për biznese dhe institucione nuk është i njohur meqë komuna nuk ka të dhëna mbi numrin e bizneseve aktive dhe institucioneve në komunë.

Tabela 5: Mbulimi me shërbim në territorin e komunës							
Emri i operatorit	Numri i EF	Numri i EF të shërbyera	Mbulim i me shërbim EF	Numri i bizneseve aktive	Numri i bizneseve të shërbyera	Numri i institucioneve	Numri i institucioneve të shërbyera
Ekohigjiena Sh.A	17,115	15,959	93,2%	NA	1,137	NA	123

Tipologjia e ofrimit të shërbimit:

Tabela në vijim e ndanë zonën e shërbimit në tre seksione: zona urbane qendra, zona periurbane dhe zona rurale. Në qytet mënyra predominante e shërbimit është me kontejnerë të përbashkët ndërsa në zonën rurale forma e shërbimit është derë më derë. Frekuenca e shërbimit për zonën urbane është 1 – 2 herë në ditë varësisht nga sezona dhe gjenerimi i mbeturinave ndërsa në zonën rurale mbeturinat grumbullohen një herë në javë. Sa i përket infrastrukturës ndarëse ajo nuk ekziston në komunë dhe mbeturinat hedhen në kontejnerë/shporta në mënyrë të përzier dhe si të tilla grumbullohen nga operatori.

Tabela 6: Tipologjia dhe frekuenca e ofrimit të shërbimit				
Vendbanimi	EF të shërbyera derë më derë %	Frekuenca e shërbimit	EF të shërbyera me shporta / kontejnerë të përbashkët %	Frekuenca e shërbimit
Zona urbane qendra ³	20%	Çdo ditë	100%	261
Zona rurale	80%	1- në javë	100%	52

Asetet e hudhjes, grumbullimit dhe transportit të mbeturinave komunale:

Në Gjilan shumica e mjeteve të hudhjes së mbeturinave janë shportat 120l dhe 240l dhe me një kontigjent më të vogël të kontejnerëve 1.1m³. Gjendja e këtyre pajisjeve të hudhjes është kryesisht e mirë megjithatë nevojiten investime të vazhdueshme në ripërtëritjen e tyre.

Tabela 7: Pajisjet për hudhjen dhe grumbullimin e mbeturinave			
Lloji i kontejnerit	Numri	Gjendje të mire %	Gjendje jo të mire %
Shporta 120 l	3,250	90 %	10%
Shporta 240 l	5,300	70 %	30%
Kontejnerë 1.1 m ³ metalik	675	90%	10%

³ Ndërtesa shumëkatëshe me banim kolektiv

Operatori i shërbimit ka në dispozicion një autopark prej 10 kamionëve të cilët kryesisht janë në gjendje të mirë operative. Megjithatë shumica e këtyre kamionëve janë të vjetër 20 vite e më shumë dhe si të tillë kanë defekte më të shpeshta dhe harxhim të karburanteve dhe lirim të gazrave serrë.

Tabela 8: Pajisjet për grumbullim dhe transport të mbeturinave

Brendi	Tipi	Kapaciteti ton	Viti i prodhimit	Targat	Gjendja operative
Iveco	MP 190 37 H	5,3	2001	06 761 BS	Defekt
Iveco	MP 190 37 H	5,3	2001	06 948 AH	E mire
Mitsubishi	Fuso Canter Fe	4	2009	06 715 BC	E mire
Mitsubishi	Fuso Canter Fe	4	2009	06 716 BC	E mire
Mitsubishi	Fuso Canter Fe	4	2010	06 837 BH	E mire
Man	26 360	11,7	2007	06 346 BT	E mire
Mercedes	25 29	12	2008	06 623 EN	E mire
Mercedes	25 29	12	2008	06 672 EM	E mire
Mercedes	/	12		06 641 EM	E mire
Mercedes	Atego 815	4	1999	06 639 EM	E mire
Mercedes 815 d		4	2003	06 935 FK	E mire
Vë	Crafter	2		06 995 EO	E mire
Skipper	Hitachi	0	2001	06 607 DR	E mire
Shkoda	Fabia	0		06 247 BS	E mire
Opel	Combo	0	2008	06 336 DT	E mire
Opel	Astra	0		06 466 DO	E mire
Man	26 320 TGS	11	2009	06 416 FG	E mire
Mercedes	Atego 18 18	6,3	2004	06 522 FG	E mire

2.3 Rishikimi i implementimit të planit

Komuna e Gjilanit në planin e menaxhimit të mbeturinave 2016-2020, ka pasur 6 objektiva kryesorë si: hartimi i kuadrit ligjor për MM, konsolidimi i shërbimit, nxitja e iniciativave për minimizimin e gjenerimit të mbeturinave, rritja e nivelit të arkëtimit, mbledhja e ndarë e mbeturinave në fraksione të caktuara, si dhe eliminimi i deponive ilegale.

Në tabelën në vijim janë pasqyruar më detajisht objektivat e planit, treguesit e suksesit, caqet e planifikuara, realizimin e tyre, si dhe janë dhënë komentet konkrete për secilin objektiv. Në përgjithësi rezultatet e realizimit të caqeve janë modeste për shkak të mungesave infrastrukturore dhe kapaciteteve institucionale. Poashtu vlen të ceket se edhe disa objektiva të planit nuk kanë qenë realiste dhe disa tjerë jo dhe gjithaq relevante.

Sido që të jetë ky rishikim i PKMM aktual, duhet të na shërbej si një mësim dhe si orientim për hartimin e PKMM në vijim, me qëllim që të adresohen qartë rrethanat dhe arsyet që kanë ndikuar në mospërbushjen e objektivave.

Tabela 9: Pasqyra e realizimit të objektivave të PKMM aktual

	Objektiva e MM	Treguesi i performancës	Caku	Realizimi	Favorshëm / pafavorshëm	Koment
1	Mbulimi me shërbim të grumbullimit dhe transportit	%	100%	93%	Pafavorshëm	Mungesa e infrastrukturës
2	% e mbeturinave të mbledhura që shkon në deponi	%	65%	100%	Pafavorshëm	Mungesa e infrastrukturës
3	% e mbeturinave të ndara	%	30%	0%	Pafavorshëm	Mungesa e infrastrukturës
4	Përpilimi i rregullores së MMN dhe miratimi nga Asambleja e Komunës	Po / jo	1	1	Favorshëm	
5	Përpilimi, miratimi dhe rishikimi çdo vit i politikës tarifore për MMN duke synuar mbulimin e kostos	Po / jo	1	0	Pafavorshëm	Mungesë e kapaciteteve institucionale
6	Ngritja e sistemit të paralajmërimit duke përfshirë edhe aplikacionin TrashOut (pa mbeturina) për deponitë ilegale	Po / jo	1	0	Pafavorshëm	Mungesë e kapaciteteve institucionale
7	Përpilimi i dokumentit të politikës, përfshirë dhe instalimin e një strukture dhe sistemi publik për ndarjen e mbeturinave	Po / jo	1	0	Pafavorshëm	Mungesë e kapaciteteve institucionale
8	Ngritja dhe pajisja e njësisë komunale për menaxhimin e mbeturinave	Po / jo	1	1	Favorshëm	
9	Krijimi i zyrës së informacionit për MMN, zyrës së pritjes dhe telefonit të gjelbër (24h)	Po / jo	1	0	Pafavorshëm	Mungesë e kapaciteteve institucionale
10	Ngritja e sistemit për monitorimin dhe raportimin periodik mbi performancën e kompanisë RMM dhe performancën e MMN	Po / jo	1	0	Pafavorshëm	Mungesë e kapaciteteve institucionale
11	nr. i pikave të grumbullimit për hedhjen e pajisjeve elektrike dhe elektronike	Nr. pikave	6	0	Pafavorshëm	Mungesë e kapaciteteve institucionale

2.4 Performance e shërbimit

Efikasiteti i stafit të ofruesit të shërbimeve:

Stafi i angazhuar në ofrimin e shërbimeve përfshin stafin direkt të angazhuar në operime si dhe stafin indirekt dhe administrativ të cilët i mbështesin ofrimin e shërbimit të MM. Numri i stafit total është 63 dhe raporti staf direkt staf administrativ është 55% / 45%. Pasiqë stafi administrativ i shërben edhe komunat tjera atëherë ky raport përmirësohet. Në përgjithësi efikasiteti i stafit të Ekohigjiena në komunën e Gjilanit është më i favorshëm se në komunat tjera edhe pse stafi i operatorit është i angazhuar vetëm në grumbullimin e mbeturinave mikse dhe jo në ndonjë aktivitet të ndarjes dhe riciklimit.

Tabela 10: Efikasiteti i stafit të shërbimeve të MM

Kategoria	Numri i stafit
Stafi direkt	
Kryepunëtorë	2
Shoferë	12
Punëtorë	21
Total staf direkt:	35
Staf indirekt dhe administrativ	
Drejtorët e bordit	6
Menaxhmenti i lartë ⁴	5
Zyrtarë të rangut të mesëm	14
Staf teknik	2
Zyrtarë të rangut fillestar	1
Staf tjetër	
Total staf indirekt dhe administrativ:	28
Total staf të MM	63
Mbeturina të grumbulluara	25,125
Efikasiteti i stafit / ton mbeturina të grumbulluara	2,57
EF të shërbyera	17,219
Efikasiteti i stafit / EF të shërbyera	3,66

⁴ KE, ZKF, drejtorët e departamenteve, dhe pozita tjera të larta.

Performanca e aseteve të grumbullimit dhe transportit:

Konsumi i naftës mesatare është 4,47 l/ton dhe i njëjti mundet të jetë më i mirë kur kihet fakti se komuna e Gjilanit nuk e ka larg deponinë sanitare siq është rasti me komunat tjera. Në këtë joefikasitet ka ndikuar e një pjese të makinerisë së vjetëruar e cila nuk është gjithaq efikase.

Tabela 11: Performanca e grumbullimit dhe transportit të mbeturinave	
Kategoria	Performanca
Kamionët në operim	13
Kapaciteti maksimal operues (ton)	92
Mbeturinat e Grumbulluara (ton/vit)	25,125
Xhiro (xhiro/vit)	5,178
Kilometrazhi (km/vit)	??
Konsumi i naftës (l/vit)	85 009
Efikasiteti i Shfrytëzimit %	
Efikasiteti i shfrytëzimit të kamionëve	90 %
Konsumi i naftës l/100km	78.10
Konsumi i naftës l/ton	4.47

2.5 Performanca financiare e MM**2.5.1 Shpenzimet e shërbimit të MM**

Struktura e shpenzimeve për ofrimin e shërbimeve shpalos faktin se shumica dërmuese e shpenzimeve shkojnë në paga dhe amortizimi është shumë i vogël për shkak të aseteve të vjetëruara. Operatori duhet të përmirësoj efikasitetin e operimit për të siguruar fonde shtesë për investime të ripërtëritjes kapitale.

Tabela 12. Shpenzimet e shërbimit të MM		
Kategoria e kostove dhe shpenzimeve	Kostot (€/vjet)	Pjesëmarrja %
Shpenzimet e pagave	278 520,00	54,6%
Shpenzimet e materialit direkt ⁵	117 442.00	22,9%
Shpenzimet indirekte dhe administrative	84 008.00	16,5%
Amortizimi	28 978.20	6%
Total:	508 948.2	100%

2.5.2 Të hyrat dhe arkëtimi i ofrimit të shërbimeve të MM

Amvisëritë janë kategoria më e rëndësishme e të hyrave 69,9% e pasuar nga bizneset 19,0% dhe institucionet 7,8%. Shkalla e arkëtimit është 89,7% ndërsa për amvisëri ajo është 84,6%.

⁵ Nafta, pagesa e deponisë, mirëmbajtja dhe riparimet e kamionëve dhe kontejnerëve, regjistrimi i kamionëve, etj.

Tabela 13: Të hyrat dhe arkëtimi i ofrimit të shërbimeve të MM

	Të hyrat		Arkëtimi	
	€	%	€	%
Të hyrat operative				
-Amvisëritë	754 080	69,9%	683 412	84,6%
-Bizneset	204 501	19,0%	200 041	98%
-Institucionet	84 488	7,8%	84 087	99,5%
-Nga shërbimet tjera të kontraktuara	35 376	3,3%	35 376	100%
Total:	1 078 445	100%	967 540	89,7%

2.5.3 Mbulimi i kostove dhe efikasiteti i operimit

Kostot e menaxhimit të mbeturinave janë për një sasi më të mëdha se të hyrat (94,4%). Nëse krahasohen me arkëtimin ky tregues bie në 90%. Komuna dhe operatori duhet t'i intensifikojnë përpjekjet që performanca financiare dhe operative e shërbimit të përmirësohet. Kjo është posaqërisht e rëndësishme kur khet parasysh fakti se kemi ngritje të qmimeve të naftës dhe të deponisë.

Tabela 14: Mbulimi i kostove dhe efikasiteti i operimit	
Kostot e MM	
Të hyrat e MM	1 078 445
Arkëtimi	967 540
Shkalla e mbulimit nga faturim i%	94.48 %
Shkalla e mbulimit nga arkëtimi %	89.72 %
Kosto për ton të mbeturinave	

2.6 Infrastruktura për ndarje, riciklim dhe deponim të mbeturinave

Deponia

Komuna e Gjilanit shërbehet me deponinë e Velekincës e cila menaxhohet nga KMDK. Të gjitha mbeturinat e grumbulluara nga komuna dërgohen në këtë deponi për deponim. Tarifa e deponimit është 6,07 €/ton për mbeturina komunale ndërsa 50 €/ton të qelqit dhe mbeturinave shtazore nga therrëtoret. Megjithatë këto tarifa priten të rriten progresivisht me fillim nga viti 2023 e tutje.

2.7 Menaxhimi i kategorive tjera të mbeturinave

- Menaxhimi i mbeturinave të vëllimshme

Menaxhimi i këtyre mbeturinave ende nuk është i organizuar në komunën e Gjilanit dhe kjo shihet si njëra nga shkaqet e prezencës së hudhjes së këtyre artikujve rreth kompjuterëve dhe në deponi ilegale.

- Menaxhimi i mbeturinave nga ndërtim demolimi:

Komuna ka caktuar lokacion për MND por kjo deponi nuk është e pajisur me infrastrukturë adekuate. Poashtu komuna nuk e ka kaluar procesin tariforë. Për shkak të dobësive në zbatimin ligjor është e shprehur hudhja e këtyre mbeturinave në vende të paërshtatshem duke i dhënë hov dukurisë së deponive ilegale në komunë.

- Menaxhimi i mbeturinave shtazore

Këto mbeturina shpeshherë hedhen në kontejnerë komunal dhe për rrjedhojë dëmtohet operatori i cili detyrohet të paguaj tarifa të larta si dhe në deponi ilegale. Poashtu mosrealizimi i qendrës përpunuese në Zonën Industriale Drenas e ka dëmtuar këtë kategori të mbeturinave.

- Menaxhimi i mbeturinave medicinale

Menaxhimi dhe grumbullimi i mbeturinave mjekësore bëhet nga kompani të licensuara të cilat fraksionet e mprehta dhe pajisjet i dërgojnë për sterilizim ndërsa pjesën infektive për incinerim tek qendra rajonale spitalore. Megjithatë menaxhimi i kësaj kategori të mbeturinave nuk është në nivelin e dëshiruar.

- Menaxhimi i kategorive tjera të mbeturinave

Në komunë e Gjilanit nuk ka formë të organizuar të menaxhimit të kategorive tjera të mbeturinave dhe operatorët që operojnë me to nuk janë të licencuar dhe rrjedhimisht nuk i zbatojnë veprimet e tyre në harmoni me kuadrin ligjor.

3 Objektivat e MM dhe plani operacional

3.1 Vizioni i MM

Komuna e Gjilanit synon që të ofrojë shërbime të menaxhimit të mbeturinave gjithë qytetarëve të saj. Krahas këtij veprimi komuna synon që të ngrisë kualitetin e shërbimeve duke bashkëpunuar me qytetarët e saj dhe akterët tjerë relevant.

Duke promovuar konceptin 3R dmth zvogëlim, ripërdorim, dhe riciklim komuna synon që gradualisht të fillojë të ndajë mbeturinat (nga ekonomi familjare, tek shkollat dhe institucionet, dhe biznese), të edukojë qytetarët rreth përfitimeve për ndarje të mbeturinave dhe të krijojë infrastrukturë për zhvillim ekonomik lokal, pra të krijojë mundësi qytetarëve që të krijojnë biznese financiarisht të qëndrueshme në sektor. Përfundimisht, komuna synon që të krijojë një mjedis më të pastër për qytetarët e saj, gjë që do të ndikonte në ngritjen e mirëqenies për qytetarë.

3.2 Objektivat dhe caqet e MM

Formati i standardizuar i PKMM përmban pesë objektiva të paraqitur në tabelën e mëposhtme (edhe pse lista nuk është e kufizuar):

Tabela 15: Lista e propozuar e objektivave të planit	
Numri objektivit	Emërtimi
Objektivi 1	Parandalimi dhe minimizimi i gjenerimit të mbeturinave
Objektivi 2	Ripërdorimi dhe riciklimi i mbeturinave
Objektivi 3	Ofrimi i shërbimeve cilësore, efektive dhe efikase të shërbimeve
Objektivi 4	Trajtimi dhe deponimi i sigurt i mbeturinave si mjeti i fundit
Objektivi 5	Zhvillimi i kapaciteteve institucionale për menaxhimin e mbeturinave

3.3 Objektivi 1: Parandalimi dhe reduktimi i krijimit të mbeturinave

Komuna e Gjilanit është e përkushtuar që të bëjë hapa të vendosur në parandalimin respektivisht reduktimin e gjenerimit të mbeturinave. Parandalimi dhe reduktimi i gjenerimit të mbeturinave shkon në linjë me hierarkinë e prioriteteve të menaxhimit të mbeturinave të sanksionuar me ligj dhe strategji.

Tabela 16: Korniza strategjike e Objektivit 1						
Treguesi i performancës	Vlera bazë	Caku				
	2022	2023	2024	2025	2026	2027
Mbeturina të grumbulluara për kokë banori (kg /pcp /ditë)	1.05	1.0	0.95	0.90	0.85	0.80

Riorganizimi i shërbimit për të mundësuar matjen e gjenerimit	-	-	1	-	-	-
Zbatimi i tarifave volumetrike		-	-	1	-	-
Futja e pakos stimuluese	-	-	-	1	-	-
Shpërndarja e komposterëve individual	-	-	-	50	50	50
Zbatimi i fushatës informative	-	1	1	1	1	1

3.3.1 Masat dhe aktivitetet për zbatimin e Objektivit 1

Riorganizimi i shërbimit për të mundësuar zbatimin e tarifave me bazë matjen:

Mënyra e organizimit të tanishëm të shërbimit përveq bizneseve të mëdha dhe institucioneve nuk bazohet në matjen e mbeturinave të gjeneruara për grumbullim. Edhe tek rasti i grumbullimit derë më derë për amvisërit në zonat rezidenciale dhe rurale prap nuk bëhet matja për amvisëri të shërbyer. Kjo mënyrë e shërbimit e pamundëson zbatimin e tarifave në bazë të matjes dhe si e tillë duhet të transformohet. Poashtu ofruesit e shërbimeve nuk e kanë teknikën e as kapacitetin për ta zbatuar volumetrinë.

Për të riorganizuar shërbimin nevojitet:

- **Plani i riorganizimit të shërbimit** i cili do të mundësoj zbatimin e matjes së mbeturinave në pikën e grumbullimit
- Sigurimi i infrastrukturës për matjen e gjenerimit të mbeturinave të grumbulluara
- Trajnimi i stafit të ofruesit të shërbimeve për të zbatuar skemën PAYT

Zbatimi i tarifave volumetrike bazuar në matje

Tarifat aktuale janë të përcaktuara në bazë të sasisë së paramenduar të gjenerimit të mbeturinave për amvisëritë dhe bizneset. Problemi me këto tarifa është se nuk e promovojnë reduktimin e gjenerimit të mbeturinave përmes pagesës ndërsa disa konsumatorë me gjenerim më të madh përfitojnë nga pagesa më e ulët se kostoja e shërbimit. Për të kaluar në tarifat volumetrike nevojiten aktivitetet sa vijon:

- Kalimi i tarifave të shërbimit në bazë të matjes
- Azhurnimi i softuerit të faturimit që të mundësoj tarifën e bazuar në matje
- Zbatimi i tarifave PAYT

Nxjerrja e pakos stimuluese për bizneset me „zero ambalazhim“ dhe „zero mbeturina“:

Komuna ka interes që të zhvilloj ekonomi lokale të bazuar në ekonomi qarkore dhe bazë të qendrueshme. Ideja është që këto biznese të veprojnë në drejtim të minimizimit dhe reduktimit

të mbeturinave. Në vendet e BEs dhe më gjerë po hapen dyqane të cilat shesin produktet e tyre pa ambalazhim si dhe restorantet të cilat i kompostojnë mbeturinat e tyre nga ushqimet.

Ideja është që këto dyqane të jenë më konkurente me çmime më të lira të cilat do i bënin atraktive për konsumatorët. Poashtu konsumatorët me vetëdije më të lartë mjedisore do tu ofrohej mundësia që të i kryenin furnizimet në këto dyqane.

Komunat mundën të luajn rolin e tyre që të i promovojnë këto biznese dhe përmes lehtësimeve fiskale të e lehtësojnë afarizmin e tyre. Disa nga masat të cilat do ti ndërmerr komuna janë:

- Studimi i mënyrës së futjes së stimujve fiskal dhe kostove dhe përfitimeve
- Futja e stimujve të përshtatshëm fiskal përfshi tarifatat preferenciale;
- Analizë e zbatimit të prokurimit të gjelbër për këto subjekte;

Shpërndarja e komposterëve për shtëpi rezidenciale dhe restorante “zero mbeturina”:

Komuna do të shpërndaj falas apo me bashkëfinancim komposterë individual të cilët do të reduktojnë mbeturinat që do të hudhen në kontejnerët apo shportat që do të grumbullohen dhe transportohen nga operatori.

Rritja e ndërgjegjësimit të konsumatorëve për çështjet e minimizimit dhe reduktimit të gjenerimit të mbeturinave përmes fushatave informuese.

Komuna do të organizoj fushatë informuese për qytetarët bizneset dhe institucionet mbi rëndësinë e parandalimit dhe reduktimit të gjenerimit të mbeturinave si dhe këshillat për ta arritur këtë objektivë.

3.4 Objektivi 2: Ripërdorimi dhe riciklimi i mbeturinave

Fokusi primar i këtij objektivi ka të bëjë me ripërdorimin dhe riciklimin e mbeturinave komunale si dhe kategorive tjera të mbeturinave nën kompetencë komunale me theks të veçantë në MND, mbeturinat e vëllimshme dhe mbeturinat komerciale.

Edhe pse gomat, produktet elektrike dhe elektronike, bateritë etj., nuk janë kompetencë komunale, megjithatë duke iu referuar kuadrit ligjorë dhe praktikave të jashtme, komuna do të organizoj skemën e grumbullimit të organizuar të këtyre mbeturinave në kuadër të skemës së përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit.

Tabela në vijim jep kornizën strategjike për objektivin 2 së bashku me disa masa aktivitete të propozuara:

Tabela 17: Korniza strategjike e Objektivit 2								
Nr.	Masat / aktivitet / treguesi i performancës	Treguesi	Vlera bazë	Caku				
			2022	2023	2024	2025	2026	2027
2.1	Studimi i gjenerimit dhe kompozicionit të mbeturinave	Studimi i gjenerimit dhe kompozicionit është zbatuar			1			
2.2	Studim i fizibilitetit të ndarjes së mbeturinave në burim dhe riciklimit dhe modelit të operimit të grumbullimit, transportit dhe riciklimit të mbeturinave komunale	Studimi i fizibilitetit është zbatuar		1				
2.3	Zgjerimi i mbulimit me shërbim të ndarjes së mbeturinave në burim	% EF me shërbim të ndarjes në burim		10%	20%	30%	40%	50%
2.4	Riciklimi i mbeturinave të riciklueshme jo-degraduese	% e riciklimit të plastikës, letres, kartonit, qelqit dhe metalit.	0%	5%	10%	15%	20%	25%
2.5	Riciklimi i mbeturinave bio-degraduese	% e riciklimit të mbeturinave ushqimore dhe mbeturinave tjera biodegraduese	0%	5%	10%	15%	20%	25%
2.6	Kontraktimi i operatorit të licencuar për grumbullimin dhe transportin dhe riciklimin e mbeturinave të riciklueshme jo-degraduese	Operatori është kontraktuar			1			
2.7	Kontraktimi i operatorit të licencuar për grumbullimin dhe transportin dhe riciklimin e mbeturinave bio-degraduese	Operatori është kontraktuar			1			
2.8	Studimi i fizibiliteti për modelin e operimit të qendrës së grumbullimit dhe ripërdorimit	Studimi i fizibilitetit është zbatuar			1			

2.9	Funksionalizimi i qendrës së grumbullimit dhe riciklimit	Qendra e grumbullimit është funksionalizuar dhe futur në operim				1		
2.10	Studimi i fizibilitetit për modelin e operimit të grumbullimit, transportimit dhe riciklimit të MND në komune.	Studimi i fizibilitetit është zbatuar			1			
2.11	Kontraktimi i operatorit të licencuar për MND	Operatori është kontraktuar				1		

Analiza e potencialit të gjenerimit, kompozicionit dhe riciklimit të mbeturinave në komunë

Analiza në fjalë nisët nga parashikimet demografike të popullatës.

Tabela 18: Parashikimet demografike të popullatës						
Vendbanimi	Numri i popullatës					
	2022	2023	2024	2025	2026	2027
Qyteti (banorë)	54,239	54,239	54,239	54,239	54,239	54,239
Zona ruarle (banorë)	35,939	35,939	35,939	35,939	35,939	35,939
Total banorë	90,178	90,178	90,178	90,178	90,178	90,178

Parashikimi i gjenerimit të mbeturinave dhe kompozicionit të tyre është dhënë në tabelat në vijim i bazuar në të dhënat e grumbullimit të KRM Ekohigjiena⁶.

Tabela 19: Parashikimi i gjenerimit të mbeturinave						
	2022	2023	2024	2025	2026	2027
Popullata në zonën urbane	54 239	54 239	54 239	54 239	54 239	54 239
Gjenerimi për kokë banori ZU	301	301	301	301	301	301
Gjenerimi i mbeturinave ZU	16 326	16 326	16 326	16 326	16 326	16 326
Popullata në zonën rurale	35 939	35 939	35 939	35 939	35 939	35 939
Gjenerimi për kokë banori ZR	301	301	301	301	301	301
Gjenerimi i mbeturinave ZR	10 818	10 818	10 818	10 818	10 818	10 818
Gjenerimi vjetor i mbeturinave	27 144	27 144	27 144	27 144	27 144	27 144

Tabela 20: Parashikimi i gjenerimit të mbeturinave sipas kompozicionit						
	Fraksioni	2023	2024	2025	2026	2027
%	Letër dhe karton	19,15%	19,19%	19,22%	19,24%	19,26%
	Qelq	6,45%	6,46%	6,47%	6,48%	6,49%

⁶ Meqë sasia e mbeturinave në Gjilan është më madhe se e qytetit të Pejës rrjedhimisht nuk mundën të përdoren rezultatet e analizës së Pejës pasi që do të rezultonte në parashikim më të ulët të mbeturinave. Por komuna duhet sa më parë që të zbatoj analizat e kompozicionit dhe të gjenerimit.

	Mbeturina bio-degraduese nga kuzhinat dhe mensat	34,45%	34,53%	34,58%	34,62%	34,64%
	Tekstil dhe veshjet	5,85%	5,86%	5,87%	5,88%	5,88%
	Pllastika	19,45%	19,49%	19,52%	19,55%	19,56%
	Metal	1,05%	1,05%	1,05%	1,06%	1,06%
	Të tjera	13,60%	13,63%	13,65%	13,67%	13,68%
ton	Letër dhe karton	5 198	5 209	5 217	5 223	5 228
	Qelq	1 751	1 754	1 756	1 759	1 762
	Mbeturina bio-degraduese ⁷	9 351	9 373	9 386	9 397	9 403
	Tekstil dhe veshjet	1 588	1 591	1 593	1 596	1 596
	Pllastika	5 280	5 290	5 299	5 307	5 309
	Metal	285	285	285	288	288
	Të tjera	3 692	3 700	3 705	3 711	3 713

Në tabelën në vijim janë dhënë caqet preliminare të komunës karshi ripërdorimit / riciklimit të fraksioneve të riciklueshme jodegraduese si letra, plastika, qelqi dhe metali si dhe mbeturinat biodegraduese.

Tabela 21: Caqet e riciklimit					
Fraksioni	2023	2024	2025	2026	2027
Të riciklueshmet jo-degraduese %	5%	10%	15%	20%	25%
Të riciklueshmet jo-degraduese (ton)	626	1 254	1 884	2 515	3 147
Të riciklueshmet biodegraduese %	5%	10%	15%	20%	25%
Të riciklueshmet biodegraduese (ton)	468	937	1 408	1 879	2 351

Megjithatë për caqe më të sakta të ripërdorimit dhe riciklimit komunat do të zbatoj studimin e gjenerimit dhe kompozicionit si dhe një **studim të fizibilitetit të ndarjes së mbeturinave në burim dhe riciklimit**.

Avancimi i sistemit të ndarjes dhe riciklimit të mbeturinave komunale:

- Zgjerimi i infrastrukturës për ndarje në burim të mbeturinave komunale;

Komuna e Gjilanit është e përkushtuar që të bëjë ndarjen në burim të mbeturinave komunale. Format e ndarjes varen nga faktorë të ndryshëm dhe mundë të marrin forma sa vijon:

- Ndarja në dy fraksione „thatë dhe të lagësht“ me grumbullim derë më derë
- Ndarja në tre fraksione „recikluese jo-biodegraduese, „biodegraduese dhe reziduale“ me grumbullim derë më derë
- Ndarja në dy fraksione „thatë dhe të lagësht“ me grumbullim me kontejnerë të përbashkët
- Ndarja në tre fraksione „recikluese jo-biodegraduese, „biodegraduese dhe reziduale“ me grumbullim me kontejnerë të përbashkët
- Ndarja në mbi tre fraksione „letër – qelq – plastikë - metal, „biodegraduese dhe reziduale“ me grumbullim me kontejnerë të përbashkët

⁷ Mbeturina bio-degraduese nga kuzhinat dhe mensat

Forma e ndarjes kushtëzohet nga tipi i vendëbanimit (rezidencial dhe banim kolektiv), kapaciteti buxhetorë, infrastruktura ricikluese e të ngjashme.

Megjithatë tipi i ndarjes së mbeturinave do të përcaktohet nga **plani i riorganizimit të shërbimit** që do ta zhvilloj komuna.

Në tabelën në vijim do të jepet orari i shtrirjes së ndarjes së mbeturinave në burim për komunën e Gjilanit:

Tabela 22: Orari i ndarjes së mbeturinave në burim						
	2022	2023	2024	2025	2026	2027
Mbulimi total me shërbim	93 %	95 %	100 %	100 %	100 %	100 %
Mbulimi me ndarje në burim	-	10 %	15 %	25 %	35 %	45 %

- Zbatimi i skemës së grumbullimit të ndarë, transportit dhe riciklimit të mbeturinave të riciklueshme jo të degradueshme:

Komuna e Gjilanit do të zbatoj një **studim të fizibilitetit të modelit të operimit të grumbullimit, transportit dhe riciklimit të mbeturinave komunale i cili përfshin si fraksion të ndarë mbeturinat e riciklueshme jo-biodegraduese**. Studimi do të bazohet në analizën e kompozicionit, tregun e të riciklueshmeve dhe sektorin e ricikluesve privat dhe poashtu do të marr parasysh kërkesat ligjore dhe politikat kombëtare të menaxhimit të mbeturinave si dhe praktikatat më të mira.

Sipas strategjisë së mbeturinave 2021 – 2030 parashihet të zbatohet skema e sistemit të kthimit të depozitës për ambalazhet e pijeve tek prodhuesit dhe tregëtarët e pijeve që paraqet një përqindje të konsiderueshme të këtyre mbeturinave. Poashtu strategjia e mbeturinave parasheh operimin e qendrave të riciklimit ku do të dërgohen këto mbeturina.

Megjithatë deri sa të zbatohet skema e kthimit të depozitës dhe funksionalizohet qendra e riciklimit komuna do të tentoj të bëjë partneritet me ricikluesit privat për të bërë grumbullimin dhe transportin e të riciklueshmeve jo-biodegraduese.

Pra komuna sa i përket mbeturinave të riciklueshme jobiodegradues do të zbatoj:

- studimin e zbatimit të modelit të operimit të grumbullimit, transportit dhe deponimit të mbeturinave të riciklueshme të padegradueshme
- zhvillimi i partneritet me ricikluesit privat për grumbullimin dhe transportin e këtyre mbeturinave
- Zbatimi i skemës së grumbullimit të ndarë, transportit dhe riciklimit të mbeturinave komunale biodegraduese

Ngjashëm si me mbeturinat e riciklueshme jo të degradueshme, komuna e Gjilanit do të zbatoj një **studim të fizibilitetit të modelit të operimit të grumbullimit, transportit dhe riciklimit të mbeturinave komunale i cili përfshion si fraksion të ndarë mbeturinat biodegraduese**.

Mbeturinat që do të përfshihen në këtë fraksion do të jenë mbeturinat nga ushqimet, vajrat e përdorura ushqimore, dhe mbeturinat nga parqet, tregjet e gjelbërta dhe hapësirat publike.

Sipas strategjisë secili rajon do të ketë një qendër të kompostimit të centralizuar ku do të dërgohen **mbeturinat biodegraduese ushqimore**. Por deri sa të ndërtohet dhe funksionalizohet kjo qendër komuna do të konsideroj zhvillimin e skemës lokale të kompostimit përmes angazhimit të operatorëve privat të interesuar që të grumbullojnë dhe transportojnë këto mbeturina.

Komuna e Gjilanit do të ndërtoj skemën lokale të kompostimit për **mbeturinat biodegraduese nga parqet, tregjet e gjelbërta dhe hapësirat publike** të cilat për shkak të specifikave të tyre duhet të kompostohen lokalisht meqë transportimi i tyre është i kushtueshëm dhe joefikas.

Sa i përket **vajrave të përdorura ushqimore** komuna do të u kërkoj objekteve gastronomike që i prodhojnë këto vajëra me shumicë të lidhin kontrata valide me operatorët të licencuar të vajërave ushqimore nga MESPI të cilët do të bëjnë grumbullimin e organizuar të këtyre vajrave. Komuna do të organizoj mbikëqyrjen dhe inspektimin e mbarëvajtjes së kësaj skeme të organizimit dhe do të shqiptoj dënime në rast të shkeljeve.

Pra komuna sa i përket mbeturinave biodegraduese do të zbatoj:

- studimin e zbatimit të modelit të operimit të grumbullimit, transportit dhe deponimit të mbeturinave komunale biodegraduese
- zhvillimi i skemës lokale të kompostimit në partneritet me ricikluesit privat
- inspektimin e lokaleve sa i përket vajrave mbeturinë

Menaxhimi i qendrushëm i mbeturinave të vëllimshme dhe komerciale:

- Hapja e qendrës së grumbullimit dhe ripërdorimit:

Komuna e Gjilanit planifikon të hap **qendrën e grumbullimit dhe ripërdorimit të mbeturinave të vëllimshme dhe komerciale me tre pika të përshtatshme për qytetarët e komunës**. Për hapjen e kësaj qendre komuna ende nuk e ka ndarë parcelën por do ta bëjë më vonë gjatë implementimit të planit.

Në këtë objekt qytetarët do të dërgojnë artikujt e padëshiruar të tyre sa vijon:

- Mobilje dhe orendi
- Tekstil dhe veshëmbathje
- Pajisje shtëpiake dhe mbeturina tjera të vëllimshme

Përpos këtyre artikujve të padëshiruar qytetarët mund të dorëzojnë edhe gomat, bateritë, vajrat mbeturinë dhe mbeturina tjera.

Komuna duhet përmes një **studimi të fizibilitetit të modelit të operimit** të qendrës të analizoj dhe të vendos se a ta menaxhoj këtë vetë këtë qendër apo ta angazhoj një operatorë privat.

Menaxhimi i qendrueshëm i mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi:

Sa i përket MND ligji parasheh caktimin e lokacionit të deponisë që është një zgjidhje e përkohshme dhe ndërtimin dhe funksionalizimin e qendrës së grumbullimit dhe riciklimit të këtyre mbeturinave e cila sipas strategjisë së mbeturinave do të organizohet në formë rajonale.

Komuna sipas ligjit e kontraktos shërbimin me operator të licencuar, cakton tarifat e shërbimit dhe se ndërtuesit kanë të drejtë që ti ndajnë dhe riciklojnë mbeturinat e tyre në kantierin e punimit si dhe ti transportojnë mbeturinat deri te destinacioni i autorizuar.

Komuna jonë tashme e ka caktuar lokacionin e deponisë. Komuna do ti dërgoj mbeturinat në këtë lokacion i cili do të operohet nga kontraktori i licencuar i cili poashtu do të kontraktohet nga komuna siq e parasheh ligji.

Komuna do të vendos kritere në kuadër të lejes ndërtimore ku do të kërkoj që ndërtuesi të ketë edhe një plan të menaxhimit të mbeturinave ku parashihet sasia e mbeturinave që do të deponohen. Inspeksioni do të mbikëqyrë këtë deponi dhe të parandaloj hudhje e këtyre mbeturinave në vendë tjera të papërshtatshme.

Në momentin e funksionalizimit të qendres rajonale komuna do ti dërgoj mbeturinat tek kjo qendër. Poashtu tarifat do të caktohen në nivel të komunes të cilat do të shërbejnë nga kjo qendër e grumbullimit dhe riciklimit të MND.

Megjithatë komuna do të zbatoj një **studim fizibiliteti të modelit të operimit të grumbullimit dhe transportit të MND si dhe të riciklimit të tyre nga ndërtuesit.**

Menaxhimi i qendrueshëm i mbeturinave nga kujdesi shëndetësor:

Komuna, respektivisht Drejtorati për Shëndetësi, por edhe Drejtorati i Inspeksionit, do të monitoroj menaxhimin e mbeturinave spitalore sipas legjislacionit në fuqi.

Inpektori komunal i mjedisit do të bëjë mbikqyrje inspektive mbi menaxhimin e mbeturinave edhe atyre medicinale në këtë rast, bazuar në Nenin 62, 63, 65, dhe 66 të Ligjit për Mbeturina.

Komuna - Drejtoria përgjegjëse për shëndetësi do të siguroj dhe vendos kontejnerë për hedhjen e barnave të papërdorura dhe me afat të skaduar direkt nga qytetarët.

Prodhuesit e mbeturinave medicinale publik dhe privat gjatë aktivitetit të tyre të kujdesit shëndetësorë, do të hudhin mbeturinat e tyre në mënyrë të klasifikuar mbeturinat sipas llojeve në kontejnerë, nën apo thasë përkatës të siguruar nga vetë ata, deri sa të grumbullohen nga operatori i licencuar që i përpunon dhe i menaxhon ato. Inspeksioni komunal në bashkëpunim me departamentin e shëndetësisë do të siguroj zbatimin e këtij obligimi ligjor.

Operatorët publik dhe privat si prodhues të mëdhenj të mbeturinave medicinale të rrezikshme do të hartojnë planin për menaxhimin e mbeturinave medicinale dhe ekzistenca e këtij plani dhe

zbatimi i tij do të kontrollohen nga inspekcioni komunal në bashkëpunim me departamentin e shëndetësisë.

Nëse institucionet shëndetësore nuk i trajtojnë vet mbeturinat spitalore që i krijojnë, atëherë duhet të kenë kontratë me operatorët e licencuar për trajtimin e këtyre mbeturinave. Inspekcioni komunal në bashkëpunim me departamentin e shëndetësisë do të kontrollojë nëse këto kontrata janë të lidhura dhe po zbatohen.

Menaxhimi i qendrueshëm i mbeturinave shtazore nga thertoret:

Sipas Strategjisë së mbeturinave, mbeturinat shtazore nga thertoret do të dërgohen tek qendra e grumbullimit dhe riciklimit në Halilaq të ndërtuar nga BE. Megjithatë kjo qendër ende nuk po funksionalizohet që po na e pamundëson organizimin e kësaj skeme.

Komuna do të organizoj këtë shërbim për fazën tranzitore deri në funksionalizim të qendrës duke i dërguar këto mbeturina nga operatori i grumbullimit të mbeturinave për të bërë varrimin e tyre të gëlqelosur dhe njëkohësisht të shikoj mundësin e angazhimit të operatorëve privat të licencuar nga AVUK që të bëjnë grumbullimin e organizuar të këtyre mbeturinave tek impijantet e tyre.

Mishtoret, therrëtoret dhe industritë përpunuese të mishit duhet të sigurojnë kontejnerë hermetik të ndarë ku do ti hudhin mbeturinat shtazore deri në momentin e grumbullimit dhe të kenë kontrata valide me operatorin të cilat do të inspektohen nga komuna në mënyrë periodike.

Aktivitet vetëdijësues për ripërdorim dhe riciklim të mbeturinave:

Komuna do të organizoj fushata informative të komunikimit me publikun sa i përket ndarjes, ripërdorimit dhe riciklimit të mbeturinave komunale, dhe kategorive tjera.

Informimi do të sqaroj se si duhet të hudhen mbeturinat në kontejnerë / shporta të ndara, për dërgimin e mbeturinave në qendrën e grumbullimit dhe ripërdorimit, dhe të ngashme. Fushata do të organizohet që të targetoj institucionet shkollore për të ngritur nivelin e edukimit mjedisorë.

3.5 Objektivi nr. 3: Ofrimi i shërbimeve cilësore, efikase dhe të qëndrueshme të MM

Objektivi 3 ka të bëjë me komponentën e shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave komunale dhe kategorive tjera të mbeturinave nën kompetencë komunale. Ky objektivi synon përmirësimin e cilësisë së shërbimeve me theks të aspekteve të qëndrueshmërisë financiare dhe të kostos.

Tabela 23: Korniza strategjike e objektivit 3								
Nr.	Aktiviteti / masa	Treguesi	Vlera bazë	Caku				
			2022	2023	2024	2025	2026	2027
3.1	Mbulimi me shërbim të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave komunale	% e popullatës së shërbyer me shërbim të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave komunale	93 %	95 %	100 %	100 %	100 %	100 %
3.2	Hartimi i planit operativ për shërbim të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave komunale është hartuar dhe miratuar	Plani operativ është hartuar dhe miratuar	1	1				
3.3	Digjitalizimi i sistemit të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave	Digjitalizimi i sistemit të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave është zbatuar	-	-	1	-	-	-
3.4	Marrja përsipër e faturimit dhe arkëtimit nga komuna për shërbimin e grumbullimit të mbeturinave	Komuna ka marrë përsipër faturimin dhe arkëtimin	-	-	1	-	-	-
3.6	Numri i ankesave të qytetarëve në shërbim të mbeturinave	Numri i ankesave të qytetarëve në shërbim të mbeturinave						

Në vijim jepen masat dhe aktivitetet kyçe të objektivës 3:

3.5.1 Zgjerimi i mbulimit me shërbim të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave

Tabelat në vijim jep orarin e zgjerimit të shërbimit dhe të dhënat e popullatës janë marrë nga ASK. Komuna është e përkushtuar që të zgjeroj ofrimin e shërbimit në tërë territorin e saj. Strategjia e zgjerimit është që fillimisht të ofrohet shërbim i plotë në zonën urbane si dhe mbulimi me shërbim edhe për zonën rurale.

Tabela 24: Strategjia e zgjerimit me shërbim

	2022	2023	2024	2025	2026	2027
Mbulimi me shërbim	93 %	95 %	100 %	100 %	100 %	100 %

Përmirësimi i cilësisë së ofrimit të shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave

Përmirësimi i cilësisë së ofrimit të shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave komunale

Komuna do të hartoj **planin e ri operativ** i cili do të bëjë planin e riorganizimit të shërbimit i cili do të rezultoj përmirësimin e cilësisë së shërbimit përmes

- Optimizimit të pikave të grumbullimit dhe frekuencës së ofrimit të shërbimit;
- Sigurimin e infrastrukturës adekuate për grumbullim dhe transport të mbeturinave komunale;

Komuna do të **digjitalizoj sistemin e grumbullimit të mbeturinave** i cili do të përmirësoj cilësinë dhe efikasitetin e shërbimit. Ky sistem do të ofroj informacionet për lëvizjet e kamionëve, informatat mbi lokacionin e kontejnerëve, nivelin e mbushjes dhe informatave tjera relevante si dhe i njëjti do të integrohet me databazën e kujdesit të konsumatorëve.

Komuna do të ndërmerr **kampanjë informative** për ti informuar qytetarët për mënyrën e re të grumbullimit të mbeturinave përfshi mënyrën e hudhjes së mbeturinave, frekuencën e shërbimit e të ngjashme.

Përmirësimi i efikasitetit operativ dhe të koston

Komuna ka përcaktuar si objektiv përmirësimin e efikasitetit operativ dhe të koston në funksion të përmirësimit të qendrueshmëris financiare. Shtyllat kryesore të këtij plani janë optimizimi i efikasitetit të stafit dhe harxhimit të naftës.

Përmirësimi i efikasitetit të stafit

Komuna do të zbatoj aktivitetet sa vijon për ta përmirësuar efikasitetin e stafit të ofruesve publik të shërbimeve:

- Kontrollin (ngrirjen) e regrutimit të stafit të ri administrativ dhe trajnimit të stafit ekzistues
- Zgjerimin e zonës së shërbimeve
- Diversifikimin dhe zgjerimin e shërbimeve
- Zhvillimi dhe monitorimi i treguesit të performancës së efikasitetit të stafit

Zyrtarët e MM dhe personat tjerë të përfshirë në planifikim, monitorim dhe mbikëqyrje të menaxhimit të mbeturinave duhet të mbajnë një kontroll strikt të numrit të stafit sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela 25: Efikasiteti i stafit

	2022	2023	2024	2025	2026	2027
Stafi direkt		-	-	-	-	-
Stafi indirekt dhe administrativ		-	-	-	-	-

Amvisëritë e shërbyera		-	-	-	-	-
Konsumatorët e shërbyer		-	-	-	-	-
Efikasiteti i stafit për konsumatorë të shërbyer		-	-	-	-	-

Ideja është që stafi administrativ të zvogëlohet karshi stafit direkt

Efikasiteti i stafit për konsumatorë të shërbyer	7.4	-	-	-	-	-
--	-----	---	---	---	---	---

Përmirësimi i efikasitetit kostos së grumbullimit dhe të harxhimit të naftës

Harxhimi i naftës është njëri ndër zërat më të lartë të kostove rrjedhëse të operatorëve të shërbimit rreth 15% të kostove rrjedhëse në nivel të sektorit dhe kjo i atribuohet në masë të konsiderueshme joefikasitetit operativ por edhe keqmenaxhimit.

Masat / aktivitetet e propozuara përfshijnë:

- **Revidimi i planit operativ** (riorganizmin e zonës dhe optimizimin e marshutave dhe frekuencës së grumbullimit)
- Zëvendësimi i kamionëve të vjetër me kamionë të rinj apo funksional (second-hand)
- Përforcimin e kontrollit të brendshëm
- Zhvillimi dhe monitorimi i treguesit të performancës së harxhimit të naftës
- Zhvillimi dhe monitorimi i treguesit të performancës së kostos njësi të grumbullimit dhe transportit

Përmirësim i performancës financiare të ofrimit të shërbimit

Komuna ka përcaktuar si objektiv përmirësimin e qendrueshmëris financiare të ofrimit të shërbimeve. Masat kryesore të përmirësimit të qendrueshmëris financiare janë:

- Kalimi i tarifave për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave mbi principet e mbulimit të kostos
- Marrja përsipër e faturimit dhe arkëtimit nga komuna

3.6 Objektivi nr. 4: Deponimi i sigurt i mbeturinave si mjet i fundit

Ky objektivi i referohet gjendjes aktuale në teren, ku për çdo vit evidentohet një numër i caktuar i vend hudhjeve ilegale të mbeturinave. Me qëllim të sanimit të gjendjes, komuna e Gjilanit do të angazhohet që për çdo vit të organizoj pastrimin e këtyre lokacioneve të ndotura me mbeturina dhe vendosjen e shenjave informuese dhe ndërgjegjësuere joftuese për mos hudhjen e mbeturinave.

Tabela 26: Korniza strategjike e objektivit 4								
Nr.	Aktiviteti / masa	Treguesi	Vlera bazë	Caku				
			2022	2023	2024	2025	2026	2027
4.1	Pastrimi i vend hudhjeve ilegale të mbeturinave	Pastrimi është realizuar	-	1	1	1	1	1
4.2	Fushatë informuese	Deponite ilegale reduktohen vazhdimisht	-	1	1	1	1	1
4.3	Inspektim dhe monitorim	Shqiptimi i gjobave		1	1	1	1	1

3.7 Objektivi 5: Zhvillimi i kapaciteteve institucionale për menaxhimin e mbeturinave

Tabela 27: Korniza strategjike e objektivit 5								
Nr.	Aktiviteti / Masa	Treguesi	Vlera bazë	Caku				
			2022	2023	2024	2025	2026	2027
5.1	Revidimi i RrK të MM	RrK e MM është reviduar	-	1	-	-	-	-
5.2	Emërimi i zyrtarit / Formimi i njësitit	Zyrtari i MM është emëruar/Spektori është formuar	1	-	-	-	-	-
5.3	Kalimi i procesit tariforë	Tarifat e reja janë kalkuluar dhe miratuar	-	-	1	-	-	-
5.4	Kontraktimi i operatorit për grumbullim dhe transport të mbeturinave komunale	Operatori i licencuar është kontraktuar	1	1	-	-	-	-
5.5	Programi i trajnimit dhe mbështetjes së proceseve për komunën dhe operatorët po zbatohet	Programi zbatohet	-	1	1	1	1	1

- Hartimi dhe miratimi i planeve komunale të menaxhimit të mbeturinave

Komuna këtë obligim është duke e kryer gjatë vitit 2022. Plani parashihet të përfundohej deri në 15 nëntor dhe drafti do të paraqitet për miratim asamblesë komunale për miratim sipas procedurave në fuqi. Komuna planifikon që ta miratoj planin gjatë vitit 2022 dhe plani do të zgjas deri në vitin 2027 ku komuna parasheh të nënshtrohet procesit të revidimit siq parashihet me ligj.

- Hartimi dhe miratimi i rregullores komunale për menaxhim të mbeturinave

Komuna e ka miratuar rregulloren komunale të MM porse parasheh që të njëjtën ta revidoj gjatë vitit 2024 për të përditësuar ndryshimet që dalin nga amendimet ligjore, hartimin e strategjisë dhe planeve kombëtare për kategori të ndryshme të mbeturinave.

- Emërimi i zyrtarëve komunal apo themelimi i njësitit për MM

Komuna e ka zbatuar këtë obligim me emërimin e zyrtarit komunal të MM.

- Emërimi i inspektorit mjedisorë

Komuna e ka zbatuar këtë obligim me emërimin e inspektorit mjedisorë të MM.

- Kalimi i procesit tariforë

Komuna e ka kaluar procesin tariforë në vitin 2021 dhe planifikon që të nënshtrohet të njëjtë gjatë vitit 2023 për të reflektuar ndryshimin e kostove dhe parametrave tjerë relevant.

- Zbatimi i programit të trajnimit dhe mbështetjes së proceseve për komunën dhe operatorët

Ky program do të dizajnohet që të i ngris kapacitetet në zbatimin e proceseve si revidimi dhe zbatimi i PKMM, amendimi i RrK të MM, kalimin e procesit tariforë, draftimin dhe monitorimin e kontratave të shërbimit dhe partneriteti publiko privat, zbatimin e skemës së përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit dhe skemës së kthimit të depozitës, ekonominë qarkore, riciklimin e mbeturinave e të ngjashme.

4 Plani i MM në kushte emergjente

Komunat duhet të bëjnë planifikimin e MM në kushte emergjente sipas kërkesave të Ligjit nr. 04/L-027 për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, planit kombëtar të reagimit emergjent të Agjencisë për menaxhimin emergjent dhe ndonjë dokumenti tjetër relevant.

Fatkeqësitë sipas ligjit konsiderohen ngjarjet të shkaktuara nga forcat madhore të natyrës apo forcat tjera të pakontrolluara, të cilat rrezikojnë jetën e njerëzve, kafshëve dhe pronave. Në fatkeqësi përfshihen: tërmetet, vërshimet, rrëshqitjet e dheut, zjarret, shpërthim i sëmundjeve infektive aksidentet që përfshijnë trafikun rrugor, hekurudhor dhe ajror, zjarret, aksidentet ekologjike dhe industriale, lufta dhe gjendja emergjente, etj.

Ngjarja e fundit që ka kualifikuar për emergjencë apo fatkeqësi ka qenë pandemia Covid 19 dhe e cila na ka ofruar disa përvoja të dobishme.

Komuna do ta amendoj planin komunal të reagimit emergjent duke shtuar kaptinën për menaxhimin e shërbimit të mbeturinave në kushte emergjente!

5 Plani financiar, veprimit dhe i monitorimit

Në tabelën në vijim janë paraqitur projektet kapitale që do mbështesin realizimin e objektivave të planit të financuara përmes buxhetit të komunës, bashkëfinancimit me komunat tjera apo me qeverinë si dhe projektet e financuara nga burimet e jashtme si qeveria donatorët, apo kapitali privat.

Tabela 28: Plani financiar, veprimit dhe monitorimit - Objektivi 1 „Parandalimi dhe reduktimi“

Masat dhe aktivitetet	Njësiti përgjegjës	Afati i implementimit dhe buxheti					2023 - 2027	Burimi i financimit
		2023	2024	2025	2026	2027		
Riorganizimi i shërbimit				95,000 €			95,000 €	
o Plani i riorganizimit të shërbimit	DSHP			20,000 €			20,000 €	Komuna
o Sigurimi i infrastrukturës matëse	DSHP			75,000 €			75,000 €	Donacion, Komuna
Zbatimi i tarifave volumetrike			17,500 €				17,500 €	
o Kalimi i tarifave PAYT (procesi)	DSHP		7,500 €				7,500 €	Komuna
o Azhurnimi i softuerit të faturimit	DSHP		10,000 €				10,000 €	Komuna
o Zbatimi i tarifave PAYT	KRM			x				KRM
Nxjerrja e pakos stimuluese për bizneset				5,000 €			5,000 €	
o Studimi i mënyrës së futjes së stimuljeve fiskal	DSHP			5,000 €			5,000 €	Komuna
o Pakoja e lehtësimeve fiskale	DSHP			x				Komuna
Shpërndarja e komposterëve për EF dhe restorante ⁸	DSHP	-	-	6,000 €	6,000 €	6,000 €	18,000 €	Komuna; Donacion
Rritja e ndërgjegjësimit për çështjet e minimizimit		1,000 €	1,000 €	1,000 €	1,000 €	1,000 €	5,000 €	Komuna
o Fushata e vetëdijësimit	DSHP	1,000 €	1,000 €	1,000 €	1,000 €	1,000 €	5,000 €	Komuna
Total objektiva 1 - Parandalimi dhe reduktimi i krijimit të mbeturinave		1,000 €	18,500 €	107,000 €	7,000 €	7,000 €	140,500 €	

Tabela 29: Plani financiar, veprimit dhe monitorimit - Objektivi 2 „Ripërdorimi dhe riciklimi“

Masat dhe aktivitetet	Njësiti përgjegjës	Afati i implementimit dhe buxheti					2023 - 2027	Burimi i financimit
		2023	2024	2025	2026	2027		
Studimi i gjenerimit dhe kompozicionit të mbeturinave	DSHP		10,000 €				10,000 €	Komuna
Ndarja dhe riciklimi i mbeturinave komunale		8,500 €	8,500 €	68,500 €	8,500 €	93,500 €	187,500 €	
o Studim i fizibilitetit të ndarjes dhe operimit	DSHP			50,000 €			50,000 €	Komuna
o Zgjerimi i mbulimit të ndarjes në burim	DSHP	5,000 €	5,000 €	5,000 €	5,000 €	5,000 €	25,000 €	Komuna
o Kontraktimi i operatorit të riciklueshmeve	DSHP			10,000 €			10,000 €	Komuna

⁸ Furnizimi me komposterë: Vitet 2023, 2024 dhe 2025 nga 50 komposterë; vitet 2026 dhe 2027 nga 100 komposterë.

Komuna e Gjilanit

o Zhvillimi i skemës lokale të kompostimit	DSHP					85,000 €	85,000 €	Komuna / donatori
o Inspektimi i lokaleve gastronomike për vajëra	DSHP	3,500 €	3,500 €	3,500 €	3,500 €	3,500 €	17,500 €	Komuna
o Bashkimi i skemës ndërkomunal të kompostimit	DSHP							Komuna
Menaxhimi i mbeturinave të vëllimshme dhe komerciale		30,000 €	100,000 €				130,000 €	
o Studimi i fizibilitetit	DSHP	30,000 €					30,000 €	Komuna
o Ndërtimi i qendrave të grumbullimit/ripërdorimit ⁹	DSHP		100,000 €				100,000 €	Komuna / donatori
o Funksionalizimi i qendrave	DSHP			x				Komuna
Menaxhimi i mbeturinave nga ndërtim demolimi			60,000 €	200,000 €			260,000 €	
o Caktimi i lokacionit	DSHP							
o Kontraktimi i operatorit	DSHP		10,000 €				10,000 €	Komuna
o Caktimi i tarifave	DSHP		5,000 €				5,000 €	Komuna
o Studimi i fizibilitetit			45,000 €				45,000 €	
o Rehabilitimi i qendrës së MND ¹⁰	DSHP			200,000 €			200,000 €	Komuna / donatori
o Bashkimi i skemës ndërkomunale të menaxhimit	DSHP					x		Komuna
Menaxhimi i mbeturinave shtazore		3,500 €	3,500 €	3,500 €	3,500 €	3,500 €	17,500 €	
o Lehtësimi i kontraktimit të operatorit privat		x	x					
o Inspektimi i zbatimit		3,500 €	3,500 €	3,500 €	3,500 €	3,500 €	17,500 €	Komuna
Menaxhimi i mbeturinave medicinale		3,500 €	3,500 €	3,500 €	3,500 €	3,500 €	17,500 €	
o Inspektimi i zbatimit		3,500 €	3,500 €	3,500 €	3,500 €	3,500 €	17,500 €	Komuna
Fushatat e vetëdijësimit		1,000 €	1,000 €	1,000 €	1,000 €	1,000 €	5,000 €	Komuna
Total objektiva 2 – Riciklimi dhe ripërdorimi		46,500 €	186,500 €	276,500 €	16,500 €	101,500 €	627,500 €	

Tabela 30: Plani financiar, veprimit dhe monitorimit - Objektivi 3 „Ofrimi i shërbimeve cilësore, efikase dhe të qëndrueshme“

Masat dhe aktivitetet	Njësi përgjegjës	Afati i implementimit dhe buxheti					2023 - 2027	Burimi i financimit
		2023	2024	2025	2026	2027		

⁹ Për komunën e Gjilanit parashihet ndërtimi i tre pikave grumbulluese dhe një qendret të ripërdorimit. Buxheti përfshin infrastrukturën përcjellëse të qendrës si rrethoja, kamerat, bazamenti, kontejnerët, etj.

¹⁰ Fizibiliteti, rrethoja, makineria dhe pajisjet e nevojshme për menaxhimin e qendrës

Përmirësimi i cilësisë së shërbimit		199,000 €	162,200 €	376,500 €	126,500 €	59,000 €	917,200 €	
o Revidimi i planit operativ	DSHP/KRM	40,000 €					40,000 €	Komuna
o Digjitalizimi i sistemit të grumbullimit	DSHP/KRM			125,000 €	15,000 €	15,000 €	155,000 €	Komuna/Donacion
o Furnizimi me shporta 120 l ¹¹	DSHP/KRM	6,000 €	6,000 €	6,000 €	6,000 €	6,000 €	24,000 €	Donacion/Komuna
o Furnizimi me shporta 240 l ¹²	DSHP/KRM	8,000 €	8,000 €	8,000 €	8,000 €	8,000 €	40,000 €	Donacion/Komuna
o Furnizimi me kontejnerë 1.1 m ³ ¹³	DSHP/KRM	45,000 €		45,000 €	67,500 €		157,500 €	Donacion/Komuna
o Furnizimi me kontejnerë 7.1 m ³ ¹⁴	DSHP/KRM		13,200 €				13,200 €	Donacion/Komuna
o Furnizimi me kontejnerë 10 m ³ ¹⁵	DSHP/KRM		15,000 €	22,500 €			37,500 €	Donacion/Komuna
o Furnizimi me kamionë ¹⁶	DSHP/KRM	100,000 €	100,000 €	150,000 €	€	€	350,000 €	Donacion/Komuna
o Furnizim me traktorë	DSHP/KRM	€	€	€	€	€	€	Donacion/Komuna
o Ndërtimi i rrethojave për kontejnerë	DSHP/KRM	€	20,000 €	20,000 €	30,000 €	30,000 €	100,000 €	Donacion/Komuna
Përmirësimi i performancës operative dhe financiare		5,000 €	25,000 €	5,000 €	5,000 €	5,000 €	45,000 €	
o Marrja përsipër e faturimit nga komuna	DSHP/KRM			x				Komuna
o Zhvillimi i softuerit të faturimit	DSHP/KRM		20,000 €				20,000 €	Komuna
o Monitorimi i performancës	DSHP/KRM	5,000 €	5,000 €	5,000 €	5,000 €	5,000 €	25,000 €	Komuna
Kampanja informative	OJU	1,000 €	1,000 €	1,000 €	1,000 €	1,000 €	5,000 €	Komuna
Total objektivi 3 „Ofrimi i shërbimeve cilësore efikase dhe qendrueshme“		205,000 €	188,200 €	382,500 €	132,500 €	65,000 €	967,200 €	

Tabela 31: Plani financiar, veprimit dhe monitorimit - Objektivi 4 „Deponimi i sigurtë si mjeti i fundit“

Masat dhe aktivitetet	Njësi përgjegjëse	Afati i implementimit dhe buxheti					2023 - 2027	Burimi i financimit
		2023	2024	2025	2026	2027		
Eliminimi i deponive ilegale	DSHP	30,000 €	25,000 €	20,000 €	15,000 €	10,000 €	100,000 €	Komuna
Inspeksioni dhe masat detyruese	Inspektorati	5,000 €	5,000 €	5,000 €	5,000 €	5,000 €	25,000 €	Komuna

¹¹ Furnizimi me shporta 120 l: 300 shporta për vit 2023 - 2027.¹² Furnizimi me shporta 240 l: 400 shporta për vit 2023 - 2027.¹³ Furnizimi me kontejnerë 1.1m³: Viti 2023 100 kontejnerë; viti 2025 100 kontejnerë dhe 2026 150 kontejnerë.¹⁴ Furnizimi me kontejnerë 7.1m³: Viti 2024 11 kontejnerë.¹⁵ Kontejnerë për mbeturina të ngurta viti 2024 10 kontejnerë dhe viti 2025 25 kontejnerë.¹⁶

Komuna e Gjilanit

Fushatat informative	DSHP	1,000 €	1,000 €	1,000 €	1,000 €	1,000 €	5,000 €	Komuna, Donacion
Total objektivi 4 „Deponimi i sigurtë si mjete i fundit“		36,000 €	31,000 €	26,000 €	21,000 €	16,000 €	130,000 €	

Tabela 32: Plani financiar, veprimit dhe monitorimit - Objektivi 5 „Zhvillimi i kuadrit dhe kapaciteteve institucionale për MM“

Masat dhe aktivitetet	Njësi përgjegjëse	Afati i implementimit dhe buxheti					2023 - 2027	Burimi i financimit
		2023	2024	2025	2026	2027		
Revidimi i RrK të MM	DSHP	7,500 €					7,500 €	Komuna
Emërimi i zyrtarit / Formimi i njësitit	DSHP	x						Komuna
Kalimi i procesit tariforë	DSHP			7,500 €			7,500 €	Komuna / KRM
Kontraktimi i operatorit për grumbullim dhe transport të MK	DSHP		10,000 €				10,000 €	Komuna
Programi i trajnimit dhe mbështetjes së proceseve	DSHP	30,000 €	30,000 €	30,000 €	30,000 €	30,000 €	150,000 €	Komuna / donatori
Total objektivi 5 „Zhvillimi i kuadrit dhe kapaciteteve institucionale për MM“		37,500 €	40,000 €	37,500 €	30,000 €	30,000 €	175,000 €	